



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2022 – Numri: 2

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E premte, 7 janar 2022

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 850, datë 29.12.2021	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022..... 155
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021	Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë..... 197
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 7.12.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar..... 276
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 17.12.2021	Për një shtesë në udhëzimin nr. 35, datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”..... 277
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 2.12.2021	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 282, datë 10.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nr. 36, datë 21.2.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2020-991, datë 28.12.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. .... 278
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 15.11.2021	Mbi shtyrjen e vendimmarrjes së Bordit në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për transferimin e aseteve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a..... 295
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 231, datë 15.11.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017..... 296

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 232, datë 15.11.2021	Mbi heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.....	297
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 236, datë 26.11.2021	Mbi zgjatjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, “Për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror ‘Albgaz’ sh.a.”.....	299
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 237, datë 26.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	299

**VENDIM**

Nr. 850, datë 29.12.2021

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË  
PËRGJITHSHËM ANALITIK TË  
PROJEKTAKTEVE QË DO TË  
PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË  
KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË  
VITIT 2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR****Edi Rama**



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2022

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katërmujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE?  Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025  Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale  Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore  Pëngjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029 dhe plani i veprimat	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	Katërmujori III	Me miratimin e ligjit nr. 75/2019 "Për rininë", i cili ka për qëllim përcaktimin e veprimtarive, mekanizave dhe autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të të rinjve, doli i nevojshëm hartimi i akteve nënligjore që rrjedhin në bazë dhe për zbatim të tij. Konkretisht, në bazë të gërmea a, të nenit 5, të ligjit nr. 75/2019 "Për rininë" Ministria përgjegjëse për rininë ka këto kompetenca: a) harton dhe propozon bazën ligjore, politikat, programet, strategjitë dhe veprimtaritë për rininë; Strategjia Kombëtare e Rinisë është një dokument që synon bashkërendimin dhe zbatimin e politikave ndërsektoriale për rininë duke filluar nga punësimi dhe arsimi, mbrojtja e shëndetit dhe mbrojtja sociale, kultura, artet, zëjet, sporti dhe vullnetarizmi, inovacioni dhe teknologjia, si dhe rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset demokratike dhe vendimmarrjen politike.	>Nxitje dhe pjesëmarrje të të rinjve në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse >Nxitja e punësimit të të rinjve >Arti, kultura, zëjet si aktivitete për të angazhuar të rinjtë në shfrytëzimin e kohës së tyre nëpërmjet aktiviteteve me vlerë >Sportet dhe shëndeti, me synim masivizimin e kulturës sportive shoqëruar me politika për mbrojtjen e shëndetit të të rinjve >Vullnetarizmi si një mundësi e mirë për të rinjtë për të rritur ndërgjegjësimin për çështje të ndryshme, si dhe për të organizuar në mënyrë të vlefshme kohën e tyre >Orientimi i brezave të rinj drejt inovacionit dhe revolucionit digjital. Ndryshime rreñjësore në mënyrën e mësimin dhe asimilimit të lëndës së teknologjisë së informacionit duke filluar me përfshirjen e kodimit që në klasën e parë dhe ndryshimin e kurrikulave të posaçme të teknologjisë së informacionit >Përmirësimi i kurrikulave, si dhe i edukimit për karrierën >Mbështetje për programet dhe propozimet e ardhura nga organizatat minore, organizatat për të rinjtë dhe njësite të vetëqeverisjes vendore me fonde të buxheut të shtetit, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Rinisë.	Po, Kapitulli 26 "Arsimi dhe kultura"	Shylla "Familja", fusha "Fëmijet", angazhimi "fillimi i punës për ndërtimin e Qendrës Kombëtare për Fëmijë brenda qershorit 2022"	n/a	Po



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2022

Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Cështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjimi me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Për miratimin e dokumentit të politikave për standardet e shërbimeve publike	Projektvendim	Ministri i Shtetit për Standardet e Shërbimeve	Katër mujori II	Krijimi i Ministrisë së Shtetit për standardet e shërbimeve/Progress-Raporti 2021/Qeverisja elektronike	Miratimi i dokumentit të politikave	Jo	Shoqëria digjitale	Nuk ka	n/a

Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2022

Ministria e Brendshme

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Cështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjimi me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruar,"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori I	Projektvendimi propozohet si akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik"	Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, synon të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike, nëpërmjet kryerjes së procedurave të përqendruar të prokurimit të fondeve buxhetore.	jo	jo	Nuk ka	Jo
2	"Për ngarkimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruar për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve të varësishme",	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori I	Projektvendimi propozohet si akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik"	Ngarkimin e Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara), si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë më kaufin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.	jo	jo	Nuk ka	Jo
3	"Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të aplikimit, rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e artit dhe kulturës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katër mujori I	Projektakti propozohet për të rregulluar me dispozita ligjore fitimin e shtetësisë nëpërmjet programit të artit dhe kulturës	Projektvendimi përcakton kushtet e përgjithshme për paraqitjen e kërkesës për shtetësi, kriteret teknike për pranimin e kërkesave, dokumentacionin e nevojshëm, procesin e vlerësimit të kërkesave në	jo	jo	Nuk ka	Jo



						kuadër të kontributit të veçantë në fushën e artit dhe kulturës				
4	Për miratimin e Rregullores "Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mbrojtjes Policore, në Ministrinë e Brendshme	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Miratimi i projektligjit të ri "Për Agjencinë e Mbrojtjes Policore" kërkon sinkronizimin e akteve nënligjore në zbatim të tij.	Kjo rregullore është e përbërë nga tre pjesë, organizimi dhe funksionimi, rregullores e personelit dhe rregullores e disiplinës. Përshatja e tyre me ndryshimet ligjore do të bëjë më efektive zbatimin e këtij ligji	jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Vendim nr. 1140, datë 24.12.2020 Për miratimin e strategjisë kundër krimtë të organizuar dhe krimeve të rënda, 2021–2025 dhe Strategjinë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit miratuar me vendimin nr. 516, datë 1.7.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 247, datë 20.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, për periudhën 2015-2020" dhe miratimin e Planit të Veprimit 2020-2023, në zbatim të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023 e të Pasaportës së Indikatoreve" dhe Planin e Integritetit	Po
5	"Për një ndryshim në VKM nr. 793, datë 24.9.2010 "Për zbatimin e ligjit nr. 10 142, datë 15.5.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë" (ndryshuar me VKM nr. 252, datë 9.2.2011 dhe nr. 657, datë 10.10.2019)	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Reformimi i SHCBA-se në Agjenci tërësisht civile kërkon që punonjësit e Agjencisë të ruajnë statusin e njëjtit së dhe e kishin me pare, ndërkohë që gjithë punonjësit të përfitojnë statusin e njëjtit me subjektet që ata mbikëqyrin.	Përfitimi i statusit nga të gjithë punonjësit e Agjencisë, kërkon ndryshimin e përcaktimit në VKM në të cilin përcaktohen se statusin e përfitojnë vetëm punonjësit me grada.	jo	Po	Nuk ka	n/a
6	Për kushtet, kriteret dhe afatet për përcaktimin e procedurës së përshpejtuar për azil	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Me ndryshimin e ligjit 10/2021 "Për azilin në RSH", është parashikuar nxjerrja e kësaj VKM-je.	Mundëson shqyrtimin e thjeshtuar të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, duke shkurtuar afatet kohore, krahasuar me procedurën e rregullt të azilit, si dhe duke respektuar njëkohësisht garancitë kryesore procedurale dhe shqyrtimin e plotë të kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare, në rastet ku kërkesa ka gjasë të jetë e pabazuar ose ka shqetësime serioze për sigurinë kombëtare dhe rendin publik.	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
7	Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të aplikimit, rregullave të kryerjes së verifikimeve dhe kontrolleve të nevojshme për fitimin e shtetësisë shqiptare për kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Projektakti propozohet për të rregulluar me dispozita ligjore fitimin e shtetësisë nëpërmjet kontributit të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit	Projektakti përcakton kushtet e përgjithshme për paraqitjen e kërkesës për shtetësi, kriteret teknikë për pranimin e kërkesave dhe dokumentacionin e nevojshëm. Kriteret lidhen me kontribut të veçantë në fushën e arsimit, shkencës dhe sportit	jo	Jo	Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani i veprimit 2019-2022. - Pjesa III, Objektivat specifike të strategjisë dhe produktet kryesore, pikat C / D.	Po
8	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 253, datë 27.4.2007 "Për përcaktimin e elementëve të sigurisë dhe për miratimin e formës dhe të modelit të dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë", i ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Përcaktimi i elementeve të sigurisë dhe formës së dokumentit të identitetit të shtetasve shqiptarë	Elementët teknikë që do të përmbajë dokumenti i identifikimit të shtetasve shqiptarë, do të jetë në përputhje me teknologjinë aktuale.	jo	Po	Nuk ka	Jo
9	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 541, datë 26.07.2006 "Për miratimin e modelit të pasaportave dhe përmirësimin e sistemit të lëshimit të tyre", i ndryshuar,	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Përcaktimi i modelit të pasaportës dhe sistemit i lëshimit të tyre	Elementët teknikë që do të përmbajë dokumenti i identifikimit të shtetasve shqiptarë, do të jetë në përputhje me teknologjinë aktuale.	jo	Po	Nuk ka	Jo
10	"Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ndryshimet që priten me hyrjen në fuqi të marrëveshjeve për "Open Balkan"	Modelet e llojeve të lejeve të qëndrimit që do të lëshohen për shtetasit e huaj	Jo	Po	Nuk ka	Po, ndikim social dhe financiar



11	“Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Përcaktimi i kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare.	Ky projektakt rregullon mënyrën e deklarimit të minoriteteve për identifikimin si persona që u përkasin pakicave kombëtare, bazuar në të drejtën e vetë identifikimit të këtyre personave dhe në dokumentacionin e Gjendjes Civile.	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
12	Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që u përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Projektvendimi propozohet si akt nënligjor në zbatim të ligjit nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”	Ky projektvendim ka si qëllim të sigurojë përdorimin e gjuhës së pakicës së njohur formalisht me ligjin nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, në marrëdhëniet midis personave që u përkasin pakicave kombëtare	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
13	Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e një pakice kombëtare	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim garanton të drejtën e një grupi shtetasish që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare, të paraqesin një kërkesë për njohjen e tyre si pakicë kombëtare, pranë një Komisioni ad hoc, të ngritur për këtë qëllim	Ky projektvendim ka si qëllim ngritjen e ë për shqyrtimin e kërkesës të depozituar nga një grup shtetasish të përbërë nga jo më pak se 300 persona, që pretendojnë se i përkasin një pakice kombëtare, pranë Ministrisë së Brendshme.	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
14	“Për karakteristikat grupore, llojet dhe parametrat teknikë të armëve të ftohta, për të cilat organi kompetent lëshon autorizim për mbajtjen nga shtetasit”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim synon miratimin e karakteristikave grupore, llojeve dhe parametrave teknikë të armëve të ftohta, për të cilat organi kompetent lëshon autorizim për mbajtjen nga shtetasit	Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e karakteristikave grupore të armëve të ftohta që kategorizohen në armë dhe the dhe pa the, si dhe standardizimin e parametrave teknikë të armëve të ftohta, për të cilat organi përgjegjës në Policinë e Shtetit lëshon autorizim për mbajtje	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
15	“Për miratimin e Rregullores “Standardet dhe teknikat e çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim garanton unifikimin dhe standardizimin e teknikave të çaktivizimit për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të këtyre armëve të zjarrit të bëhen përfundimisht jofunksionale dhe të pamundura për t'u hequr, zëvendësuar ose modifikuar, në një mënyrë të tillë që do të mundësonte inaktivizimin e mundshëm të armëve të zjarrit	Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e standardeve dhe teknikave të çaktivizimit të armëve të zjarrit dhe pjesëve kryesore të tyre, për të garantuar që të gjitha pjesët kryesore të armëve të bëhen përfundimisht jofunksionale për të mos u naktivizuar.	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
16	“Për përcaktimin e rregullave për krijimin, aksesin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori I	Ky projektvendim përcakton krijimin e regjistrit elektronik të armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre, si dhe mënyrën e funksionimit të tij, si dhe aksesin dhe administrimin	Ky projektvendim ka si qëllim përcaktimin e standardeve për krijimin, aksesin, funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik të armëve të zjarrit, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre në pronësi të personave fizikë dhe juridikë në Republikën e Shqipërisë	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
17	“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për çështjet e Brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Dhënia e disa kompetencave SHÇBA-së, si dhe vonesat në aplikimin e ligjit aktual të shtirë në kohë, duke përfshirë këtu dhe efektet financiare, kërkojnë nevojën për rishikimin e kritereve, procedurave po ashtu dhe të subjekteve	Kriteret, procedurat, subjektet e aplikimit	Jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Nuk ka	Po
18	Për një ndryshim në VKM Nr. 313, datë 15.4.2015 “Për autorizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së magazinimit, transferimit dhe asgjësimit të lëndëve plasëse për përdorim civil dhe lëndëve piroteknike fishkëzjarrë”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Ky projektvendim propozohet të ndryshohet në kuadër të procesit të deregulimit.	Lehtësimin i ofrimit të shërbimeve	Jo	Jo	Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 6.2.2019 Për miratimin e Strategjisë për Kontrollin e Armëve të	JO



									Vogla, të Lehta, Muncioneve dhe Ekiplozaveve 2019–2024 dhe të Planit të Veprimt 2019–2021	
19	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”.	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Nga studimi i praktikës së deritanshme arrijmë në konkluzion se duhet të rregullohen disa aktivitetet në shërbimin privat të sigurisë fizike.	Qëllimi është që mbi bazën e prioriteteve të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të përvojës së aritur në fushën e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe të evidentimit të problematikave të deritanshme, nëpërmjet propozimeve për ndryshime në Ligjin 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si dhe në aktet nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e këtij shërbimi, të ngrihet në një shkallë më të lartë efektiviteti i këtij shërbimi.	Jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1139, datë 24.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsëktoriale të sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimt 2021 – 2023”.	Po, ndikim social dhe ekonomik
20	Ligji nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”	Projektligj	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Përmirësimi i ligjit kryesisht për çështje të organizimit strukturor. - Janë adresuar një sërë problematikash, që konsistojnë në adresimin lidhur me raportet e projektimit të organizatës, strukturës, strategjisë, modelit të organizimit të shërbimit	Organizimi i strukturës së shërbimit Përmirësimi mënyrës së funksionimit të shërbimit vullnetar i MZSH-së. ndryshimet do të konsistojnë në disiplinimin dhe kontrollin certifikimin, homologimin, e operatorëve në tregun e sistemeve të sigurisë nga zjarri. kryesisht në autorizimin nga ministri përgjegjës për sigurinë të laboratorëve të akredituar, si dhe përmirësimi i parashikimit të sanksionit administrativ.	Jo	Po	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1139, datë 24.12.2020 “Për miratimin e strategjisë ndërsëktoriale të sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimt 2021 – 2023”.	Po
21	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake”.	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Akt nënligjor në zbatim të projektligjit “Për Policinë Bashkiake”, akt i propozuar vjen si nevojë e përcaktimit dhe organizimit të Policisë Bashkiake në harmoni me kuadrin e ri ligjor të vetëqeverisjes vendore.	a) Rritja e koordinimit midis strukturave ligjzbatuese; b) Ndarja e qartë e kompetencave të Policisë Bashkiake në raport edhe me Policinë e Shtetit dhe institucione të tjera ligjzbatuese; c) Përcaktimi i strukturës së policisë bashkiake dhe kritereve të qarta për pranimin në Policinë Bashkiake; d) Përmirësimi i aftësive profesionale; e) Risi në procesin përzgjedhës të punonjësve të policisë bashkiake; f) Përmirësimin e kuadrin rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit.	Jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Strategjia Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, e cila është miratuar me vendimin nr. 691, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave, Raport “Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe nga ligji organik nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjithashtu, nevoja e hartimit të këtij projektligji është parashikuar në politikën për krijën e parametret të sigurisë në komunitet, të Strategjisë Ndërsëktoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe të planit të veprimt 2021–2023, miratuar me vendim nr. 1139, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave. Referuar masës 15 të strategjisë është parashikuar rishikimi i rolit dhe përgjegjësitë të policisë bashkiake, si vijon: “Masat kyçe do të lidhen me rishikimin e ligjit për Policinë Bashkiake, i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura në funksion të sigurisë publike, si dhe përmirësimin e kuadrin	jo





									rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit”.	
22	Përcaktimi i procedurave, rregullave dhe mënyrave të ekuivalentimit të gradave ushtarake me ato të Gardës	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Rast pas rasti në varësi të nevojave të Gardës së Republikës do të mund të plotësohen vakancat me punonjës të Forcave të Armatosura të RSH-së nëse plotësojnë kriteret e parashikuara në ligjin për Gardën.	Parashikohet të rregullohet ekuivalentimi i gradave ushtarake me ato të Gardës së Republikës duke mundësuar kështu pranimin në strukturat e gardës të punonjësve të Forcave të Armatosura të RSH-së si një e drejtë që e parashikon neni 23 i ligjit.	Jo	Jo	Nuk ka	Jo
23	Vendim i Këshillit të Ministrave mbi përcaktimin e uniformës, automjeteve dhe elementët të Policisë Bashkiake.	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori II	Akt nënligjor në zbatim të projektligjit “Për Policinë Bashkiake”.	Me qëllim unifikimin edhe standardizimin e uniformave dhe automjeteve, me shenjat dalluese, ngjyrën, që do të përdoret policia bashkiake duke mbajtur parasysh specifikën e çdo bashkie.	Jo	Jo	Strategjia Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, e cila është miratuar me vendimin nr. 691, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave  Strategjia Ndërsëktoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe të planit të veprimit 2021–2023, miratuar me vendim nr. 1139, datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave.	jo
24	Vendim i Këshillit të Ministrave “Për Strategjinë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Planin e tij të Veprimit.”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Akt nënligjor në zbatim të ligjit organik nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ky projektvendim vjen si domosdoshmëri pasi Strategjinë Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, e cila është miratuar me vendimin nr. 691, datë 29.7.2015 të Këshillit të Ministrave, është parashikuar për periudhën 2015-2022 dhe gjithashtu plani i veprimit për periudhën 2020-2022 dhe mbaron afati i përcaktuar. Gjithashtu buron edhe Raport “Matrica e Kompetencave të Vetëqeverisjes Vendore”.	Strategjia Kombëtare Ndërsëktoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (SKNDQV) e re me qëllim për të vendosur objektivat e reja të proceseve të decentralizimit në Shqipëri. Ka si synim të informojë autoritetet përgjegjëse në Shqipëri në lidhje me progresin e arritur në lidhje me zbatimin e strategjisë, identifikimin e pengesave, dhe të nxjerrë mësimet përkatëse me qëllim ripërcaktimin dhe optimizimin e veprimeve dhe ndërhyrjeve për arritjen e objektivave dhe rezultateve të strategjisë.	Jo	Po	Vendim Nr. 1139, datë 24.12.2020 Për miratimin e Strategjisë Sëktoriale të Sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimit 2021–2023  me Strategjinë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit, Strategjinë Ndërsëktoriale E Reformës Në Administratën Publike 2015 – 2020	po
25	Plani i Veprimit 2023-2025 në zbatim të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025”	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Përfundimi i Planit aktual 2020-2021, të Strategjisë së Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda. Lufta e vazhdueshme kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda. Përmbyshja e objektivave të Strategjisë e cila është e miratuar deri në vitin 2025.	Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë . Rritja e forcës parandaluese ndaj kërcënimeve të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda	jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Vendim nr. 1140, datë 24.12.2020 Për miratimin e strategjisë kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, 2021–2025.	PO
26	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të fitimit të shtetësisë në kuadër të programit të investimit ekonomik	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Projektakti propozohet për të rregulluar me dispozita ligjore fitimin e shtetësisë nëpërmjet programit të investimit ekonomik	Projektakti përcakton kushtet e përgjithshme për paraqitjen e kërkesës për shtetësi, kriteret teknike për pranimin e kërkesave dhe dokumentacionin e nevojshëm. Në projektakt përcaktohen llojet e investimeve, fushat prioritare, kufiri monetar i investimeve, dokumentacioni ligjor dhe teknik, zonat gjeografike prioritare, si dhe tarifat e aplikimit, tarifat e due diligence dhe tarifat e tjera administrative	jo	Jo	Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani i veprimit 2019-2022. - Pjesa e III, Objektivat specifike të strategjisë dhe produktet kryesore, pikat C / D.	Po
27	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të fitimit të shtetësisë në kuadër të programit të interesit kombëtar	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Projektakti propozohet për të rregulluar me dispozita ligjore fitimin e shtetësisë nëpërmjet	Projektvendimi përcakton kushtet e përgjithshme për paraqitjen e kërkesës për	jo	Jo	Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani i veprimit 2019-2022.	Jo



					programit të interesit kombëtar	shtetës, kriteret teknike për pranimin e kërkesave, dokumentacionin e nevojshëm, procesin e vlerësimit të kërkesave në kuadër të kontributit të veçantë për interes kombëtar			- Pjesa e III, Objektivat specifike të strategjisë dhe produktet kryesore, pikat C /D.	
28	Për këshillat vendorë të sigurisë publike	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Ky projektvendim buron si akt nënligjor në zbatim të ligjit organik nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 29 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1139, datë 24.12.2020 "Për miratimin e strategjisë ndërsëktoriale të sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimit 2021 – 2023". Ky projektvendim vjen si domosdoshmëri, në mënyrë që roli i KVSPve të jetë efektiv, kontributi i komunitetit në fuqizimin dhe bashkëveprimin me KVSP-të duhet të jetë i unifikuar në 61 bashkitë e vendit.	Krijimi i një modeli të unifikuar për funksionimin e KVSP-ve dhe zbatimin e KVSP-ve në të gjitha bashkitë e vendit. Në sajë të fuqizimit të bashkëpunimit ndërsëktorial për sigurinë publike në nivel vendor duhet të përfshihen një sërë veprimesh, që synojnë: - zgjerimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor shqiptar mbi përcaktimin e kompetencave funksionale dhe procedurale në ngarkim të KVSP-ve, si dhe anëtarëve të përhershëm dhe vëzhgues, të cilët, ngarkohen të parë me të drejtë dhe detyrime në zbatim të detyrës funksionale, misionin e bashkëpunimit të institucioneve qendrore e në nivel vendor për t'u angazhuar me komunitetin, përfaqësuesit fetarë, organizatat e shoqërisë civile, si dhe aktorë të tjerë, me qëllim identifikimin dhe parandalimin e problematikave në kuadër të sigurisë publike	jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1139, datë 24.12.2020 "Për miratimin e strategjisë ndërsëktoriale të sigurisë në Komunitet 2021 – 2026 dhe të planit të veprimit 2021 – 2023".	po
29	Për miratimin e llojeve të shërbimeve shtesë që ofron Policia e Shtetit, për personat juridikë e fizikë, publikë ose privatë dhe tarifave të pagesës për këto shërbime	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Projektakti propozohet për të rregulluar ofrimin e shërbimeve shtesë të Policisë së Shtetit kundrejt pagesës	Ofrim shërbimi ndaj subjekteve private dhe përcaktimin e tarifave	jo	Po shtylla Shqipëria e fortë, fusha Shqipëria e Sigurt	Nuk ka	Jo
30	"Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë, që humbin jetën për shkak të detyrës"	Projektvendim	Ministri i Brendshëm	Katërmujori III	Projekt akti propozohet për tu ardhur në ndihmë familjarëve të punonjësve të policisë që humbin jetën për shkak të detyrës, me synim unifikimin në një akt të vetëm të formës së trajtimit të tyre.	Policia siguron mbrojtje të veçantë për punonjësin e policisë, të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës	jo	Jo	Nuk ka	Po



**Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2022**  
**Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikohen të rregullojnë projektaktit	A është parashikuar projektakti në PKIE?  Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025  Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale  Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore  Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për kriteret bazë, sektorët që do të mbështeten dhe masa e përfutimit nga fondi i programit të Skemës Kombëtare të Mbështetjes së Bujqësisë."	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Akt vjetor për të përcaktuar masat mbështetëse nga programi i mbështetjes së bujqësisë.	Përcaktohen masat që do të mbështeten gjatë vitit 2022.	Jo	Po, fusha "Zhvillimi i Bujqësisë dhe i fshatit"	Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2021	Po, ekonomike dhe sociale
2	Për miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Dokumenti bazë i sektorit. Mbarimi i afatit të strategjisë ekzistuese	Projektakti përcakton, vizionin, politikat, objektivat, si dhe masat për realizimin e tyre, shoqëruar me buxhetet përkatëse. Hartohet plani i veprimit që monitorohet bazuar në indikatorët SMART.	Po, kapitulli 11	Po, fusha "Zhvillimi i Bujqësisë dhe i fshatit"	n/a	Po. Ekonomike, sociale, mjedisore
3	"Për marrjen e masave menaxhuese për ruajtjen e burimeve peshkore"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Marrja e masave menaxhuese nga Shqipëria për ruajtjen e burimeve peshkore, në përputhje edhe me politikën e përbashkët të peshkimit të BE-së	Zbatimin e masave menaxhuese në peshkim që sigurojnë një shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve peshkore.	Po, kapitulli 15 "Peshkimi"	Jo	Jo	Po
4	"Për miratimin e Marrëveshjes për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, sigurisë ushqimore dhe ushqimit për kafshë dhe fitosanitare në Ballkanin Perëndimor"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Marrëveshja është miratuar në parim, është nënshkruar dhe duhet të miratohet pas firmosjes me vendim të Këshillit të Ministrave.	Marrëveshja formalizon me vendim të qeverive të secilit shtet, angazhimet e marra në Nish në 13.11.2021, me qëllim lehtësimin e lëvizjes dhe sigurinë ushqimore.	Jo	Jo	Jo	Po, sociale
5	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 317, datë 9.5.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve, si dhe kriteret e kualifikimit për përdoruesit".	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Vendosja e rregullave për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve dhe saktësimi i detyrave të institucioneve zbatuese.	Kontrolli në territor i përdorimit të produkteve të mbrojtjes së bimëve.	Jo	Po, fusha "Zhvillimi i Bujqësisë dhe i fshatit"	Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2021	Po
6	Për një ndryshim në vendimin nr. 613, datë 27.10.2017 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuatulturës, të ndryshuar"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Korrigjimi i sipërfaqes së objektit në administrim të DSHPA, për shkak të mospërputhjes së sipërfaqes faktike me atë të regjistruar	Pasqyrim i saktë i pasurisë nr. 2/147 ZK 8596, Aseti, Qendra e Peshkimiti Zogaj	Jo	Po	Jo	Jo
7	"Për ndryshimin e statusit nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen prej 70.5.2 m², pjesë e pasurisë me numër 371/17, zona kadastrale 2259, Bashkia Memaliaj".	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori I	Ndryshim resursi si rezultat i lejes së ndërtimit dhënë nga Bashkia Memaliaj	Ndryshim resursi me qëllim ndërtimin e strukturës "Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore	Jo	Jo	Jo	Ji
8	Per disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 475, datë 30.07.2021 "Për bashkëpunimin e njëjësive të vetëqeverisjes vendore me shërbimin veterinar"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori II	Forcimi i bashkëpunimit mes njëjësive dhe shërbimit veterinar në varësi të ministrisë përgjegjëse për Bujqësinë.	Përcaktimi i bashkëpunimit për funksionimin e të tregjeve të kafshëve që janë përgjegjësi e përbashkët.	Jo	Jo	Jo	Jo
9	Per organizimin dhe funksionimin i Institutit të Veterinarisë dhe Sigurisë Ushqimore	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori II	Detyrim për plotësim të ligjit nr. 10465/2011 me aktet nënligjore. Ligji ndryshues nr. 71/2020 parashikon projektvendimin që lidhet me institucionin përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, dhe funksionimi si qendër referencë laboratorike.	Përcaktimin e rregullave të organizimit të Institucionit përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, dhe funksionimi si qendër referencë laboratorike.	Jo	Jo	Jo	Jo
10	Për miratimin e rregullave për prodhimin, tregtimin, ruajtjen, ambalazhimin, etiketimin dhe përdorimin e produkteve plehëruese	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Detyrim që buron nga ligji nr. 17/2020 për produktet plehëruese. Kriteret dhe rregullat e hollësishme për prodhimin e produkteve plehëruese nga lënda e parë den në produktin përfundimtar. Kriteret dhe rregullat e hollësishme për prodhimin e produkteve plehëruese nga lënda e parë den në produktin përfundimtar.	Në përputhje dhe në zbatim të programit politik për zhvillimin e sektorit të Bujqësisë dhe veçanërisht me konsolidimin dhe sigurinë ushqimore për përmirësimin e prodhimit, përpunimit dhe tregimit të produkteve bujqësore për të rritur sasinë dhe sigurinë ushqimore të tyre dhe rritja e kontrollit të origjinës së produkteve bujqësore dhe blegtorale për të rritur nivelin e sigurisë ushqimore në tregjet bujqësore, blegtorale dhe në industrinë agrosushqimore.	Jo	Po, fusha "Zhvillimi i Bujqësisë dhe i fshatit"	Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2021	Jo
11	"Mbi përcaktimin e rregullave për zbatimin e sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe mbështetjen e anijeve të peshkimit për implementimin e këtij sistemi"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Me këtë akt synohet të përmirësohet raportimi dhe grumbullimi i të dhënave nga aktiviteti i peshkimit, si dhe kontrolli, duke ndikuar në një menaxhim më të mirë të resurseve peshkore.	Implementimi i sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit, si dhe mbështetjen e anijeve të peshkimit për implementimin e këtij sistemi.	Kapitulli 13 "Peshkimi"	Po	Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2021	Po
12	"Për kalimin në përgjegjësi administrimi të tokës bujqësore të dhënë me qira nga ish- Drejtoritë e Bujqësisë"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Kalimi në administrim i tokave ka karakter teknik.	Rregullon kalimin në përgjegjësi administrimi të tokës bujqësore	Jo	Jo	Strategjia Kombëtare e Konsolidimit të Tokës	Jo
13	"Institucionin përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Detyrim i plotësimit të ligjit nr. 17/2020 "Për produktet plehëruese" me akte nënligjore	Përcakton institucionin përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e prodhimit, importimit, eksportimit, ruajtjes, tregimit dhe përdorimit të produkteve plehëruese	Jo	Jo	Jo	Jo
14	"Tarifat e shërbimeve e të analizave, që kryhen nga laboratorit i referencës dhe laboratorët e miratuar"	Projektvendim	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Detyrim i plotësimit të ligjit nr. 17/2020 "Për produktet plehëruese" me akte nënligjore	Projektakti përcakton tarifat e shërbimeve e të analizave, që kryhen nga laboratorit i referencës dhe laboratorët e miratuar.	Jo	Jo	Jo	Jo
15	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8337 datë 30.4.1998, "Për kalimin në pronësi të tokës Bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave"	Projektligj	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Katërmujori III	Liberalizimi i tregut të pasurive të paluajtshme për shtetasit e BE-së, përmban një detyrim të papërbushur të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit.	Ndryshim i nenit 4 të ligjit nr. 8337/1998, për të lejuar shtetasit e huaj të marrin në pronësi pasuri të paluajtshme.	Po, kapitulli 24	Po, fusha "Zhvillimi i Bujqësisë dhe i fshatit"	Po, Strategjia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Po



16	“Për bletarinë”	Projektligji	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Mbrojta e popullatës së bletëve.	Ligji i ri, sektori i bletarisë nuk është i rregulluar.	Po, kapitulli 11	Po, fusha “Zhvillimi i Bujqësisë dhe i fshatit”	Po, Strategjia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural	Po, mjedisore
17	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2015, “Për urdhrin profesional të mjekut veterinar”.	Projektligji	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Përditësimi i ligjit me rregullimet e reja të akteve të tjera ligjore në fushën e veterinarisë.	Përcaktohet unifikimi i parashikimeve me urdhrat e tjerë profesionalë në Republikën e Shqipërisë dhe me praktikat më të mira në rajon.	Jo	Po, fusha “Zhvillimi i bujqësisë dhe i fshatit”	Jo	Po
18	“Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”	Projektligji	Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.	Katërmujori III	Kërkesë e subjekteve që posedojnë objektet prej fillimit të viteve 1990 por për arsye të mosplotësimit të dokumentacionit nuk kanë dokumentacion pronësie	Projektligji do të caktojë institucionet, kompetencat dhe kriteret e përfundimit të procesit të privatizimit.	Jo	Jo	Jo	Po

**Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2022**  
**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit**

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE? Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2021-2025 Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	“Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”	Projektligji	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Mbrojtje e mëtejshme e faunës së egër në Republikën e Shqipërisë	Të ndalojë ushtrimin e aktivitetit të gjuetisë me synim vlijimin e përmirësimit të gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuete (dhe jo vetëm) duke krijuar me krijimin e qetësisë dhe kushteve të favorshme për rimëkëmbjen e llojeve të faunës së egër objekt gjuete, por dhe të llojeve të tjera të cilat nuk janë objekt gjuete dhe që ndikohen nga gjuetia e paligjshme.	Jo	Po, projektvendimi lidhet me programin politik 2021-2025 fusha Turizmi dhe Mjedisit.	Po, projektakti lidhet me Dokumentin e Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.	Po
2	“Për Strukturën e RKFP-së, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal dhe qendror, informacioni që duhet regjistruar, si dhe afatet e përgatitjes e të raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ky projektvendim do të përgatitet në zbatim të pikës 1, të nenit 6, të Ligjit “ 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet” dhe kornizon mënyrën e mbajtjes së Regjistrat Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave, përditësimet, shtesat dhe pakësimet që ndodhin mbi fondin pyjor kombëtar.	Projektvendimi qartëson strukturën e këtij regjistri, mënyrën e mbajtjes së tij dhe detyrimet e grupeve të lidhura për të raportuar dhe përditësuar këtë regjistër.	Jo	Po. Pika 2.4 “Mjedisit” f.12.	Po, lidhet Dokumentin e Politikave Pjore në Shqipëri 2019-2030.	Jo
3	“Për miratimin e kriterëve të vendosjes dhe të funksionimit të stacioneve sezonale të bregëzimit të mjeteve lundruese”	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Ky projektakt do të përgatitet në zbatim të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 43/2020, datë 23.04.2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”. Ai synon të çlirojë potencialin dhe të përmbushë kërkesën e investitorëve në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës së bregëzimit të mjeteve lundruese turistike.	Akti përcakton kriteret e vendosjes dhe funksionimit të stacioneve sezonale të ankorimit/bregëzimit në vijën bregdetare dhe vijën bregëzore të Republikës së Shqipërisë, me synim zhvillimin e kësaj infrastrukture dhe rritjen e aktivitetit të bregëzimit, duke siguruar ruajtjen e standardeve në ofrimin e këtij shërbimi.	Jo	Po. Projektakti është në përputhje me programin politik, dhe specifikisht me zhvillimin e turizmit detar si komponente e ekonomisë blu dhe e turizmit në përgjithësi.	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023	Ky projektakt pritet të krijojë kushte pozitive për zhvillimin e disa aktivitetëve ekonomike, që sigurojnë punësim, të ardhura për buxhetin dhe ekonominë lokale. Për shkak të modelit të zhvillimit, supozohet të mos ketë impakt mjedisor.
4	“Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve”	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori I	Projektvendimi del në bazë dhe për zbatim të nenit 19 pika 5, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si detyrim ligjor që rrjedh nga ky ligj.	Të përcaktojë rregullat dhe kriteret për certifikimin e ekspertëve në fushën e pyjeve	Jo	Nuk lidhet me asnjë nga fushat.	Dokumenti i Politikave për Pyjet 2019-2030	Jo
5	“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve shtazore, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu”	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katërmujori II	Neni 36, i ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar. Të përcaktojë rregullat për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu, në mënyrë që të parandalojë dhe minimizojë rreziqet ndaj shëndetit të njeriut dhe kafshëve që vijnë nga këto produkte dhe në veçanti të mbrojtjes së sigurisë e ushqimit dhe zinxhirit ushqimor në vend.	Ky vendim do të zbatohet për nënproduktet kafshëve dhe produktet e përfuara prej tyre të cilat janë përjashtuar nga konsumi njerëzor.	Po	Po. Projektakti është në përputhje me programin politik, dhe specifikisht me menaxhimin e integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit.	Lidhet me strategjinë sektoriale të mbetjeve	Po, ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedis më pak i ndotur nga nenproduktet shtazore
7	VKM, “Për Miratimin e listës së barnave, që rimburohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të kujdesit Shëndetësor dhe masës së mbulimit të çmimit të tyre”	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor në zbatim të pikës 3, të nenit 37, të ligjit nr. 105/2014, “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, dhe të pikave 2, shkronja “b”, dhe 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	Përcaktimi i listës së barnave që do të rimburohen nga FSDKSH	Jo	Po, “Shqipëria e Shëndetshme”; Mbulimi shëndetësor falas”	Jo	Jo



8	VKM "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 24, datë 14.1.2015, "Për miratimin e strukturës dhe mënyrës së funksionimit e organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore", të ndryshuar	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori II	Detyrim ligjor, neni 17, i ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 89/2014, "Për pajisjet mjekësore", të ndryshuar	Çështje të ndryshime si rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit etj.	Jo	Po, në frymën e përgjithshme për ushtrimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore nëpërmjet institucioneve përkatëse	Jo	Jo
9	Ligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 105/2014 "Për Barnat në Shërbimin Farmaceutik", të ndryshuar	Projektligj	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Përshtatja e ligjit nr. 15/2014 me direktivat e BE	Ndryshimet kryesore që synohen të arrihen janë: Formatit tip për recetën mjekësore, Përfatimi i rregullave për fletë udhëzuesin me Direktivat e BE-së; Kriteret për hapjen e farmacive të rrjetit të hapur farmaceutik; Tregtimi në distancë i barnave; Përgatësit galenike; Parafarmacite; Reklamimi i barnave	Po. Kapitulli 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik"	Po, "Shqipëria e Shëndetshme"; Mbulimi shëndetësor falas"	Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2016-2020, Prioriteti Strategjik 2: Mbulimi shëndetësor universal për të gjithë", Objektiv 2.4.	Po, ndikime ekonomike, sociale
10	VKM "Për rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të shërbimeve për jetesë të pavarur"	Projektvendim	Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Katërmujori III	Detyrim ligjor, neni 6, pika 3 e ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara"	Rregullimi i ofrimit të shërbimeve ndërsëktoriale për PAK sipas konceptit të jetesës së pavarur. Organizimi i shërbimeve që ofrohen për jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.	Jo	Po, Shtylla I" Rimëkëmbja e Ekonomisë"; pika 4 "Familja",	Plani Kombëtar për Afësinë e Kufizuar 2016-2020	Po, ndikime ekonomike, sociale



**VENDIM**  
**Nr. 858, datë 29.12.2021**

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE,  
TË PROCEDURAVE E TË  
DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN,  
QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË  
HUAJVE NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË<sup>1</sup>**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 1, shkronja “e”, 19, pika 4, 21 pika 3, 23, pika 1, 29, pikat 1 e 6, 33, pika 6, 37, pikat 1 e 4, 56, pika 7, 81, pika 4, 84, pika 4, 91, pika 3, dhe 140, pika 1, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me

<sup>1</sup> Ky vendim është përfuar pjesërisht me:

- Direktivën (BE) 2016/801 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 maj 2016, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime kërkimi, studimesh, trajnimesh, shërbimi vullnetar, skemash të shkëmbimit të nxënësve ose projekteve arsimore dhe au pairing”. Numri CELEX 32016L0801, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 132, datë 21.5.2016, f. 21–57;

- Direktivën 2014/36/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 26 shkurt 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonalë”. Numri CELEX 32014L0036, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 94, datë 28.3.2014, f. 375–390;

- Direktivën 2014/66/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në kuadrin e një transferimi brenda korporatës”. Numri CELEX 32014L0066, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 157, datë 27.5.2014, f. 1–22;

- Direktivën 2011/98/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011, “Mbi një procedurë të vetme aplikimi për një leje të vetme për shtetasit e vendeve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një shteti anëtar dhe për një grup të përbashkët të të drejtave për punëtorët e vendeve të treta me qëndrim të ligjshëm në një shtet anëtar”. Numri CELEX 32011L0098, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 343, datë 23.12.2011, f. 1–9;

- Direktivën e Këshillit 2009/50/KE, datë 25 maj 2009, “Mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim pune shumë të kualifikuar”. Numri CELEX 32009L0050, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 155, datë 18.6.2009, f. 17–29;

- Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004, “Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara për shtetasit e vendeve të treta që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për të lehtësuar imigracionin e paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente”. Numri CELEX 32004L0081, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 261, datë 6.8.2004, f. 19–23;

- Direktivën e Këshillit 2003/109/KE, datë 25 nëntor 2003 në lidhje me statusin e shtetasve të vendeve të treta që janë rezidentë afatgjatë, e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0109, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 16, datë 23.1.2004, f. 44–53;

- Direktivën e Këshillit 2003/86/KE, datë 22 shtator 2003, “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”. Numri CELEX 32003L0086, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 251, datë 3.10.2003, faqe 12–18;

- Direktivën 96/71/KE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 1996, në lidhje me transferimin e punëtorëve në kuadrin të ofrimit të shërbimeve, e ndryshuar. Numri CELEX 31996L0071, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 18, datë 21.1.1997, faqe 1–6;

- Rregulloren (KE) nr. 810/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Për krijimin e Kodit të Komunitetit për Vizat (Kodi i Vizave)”, e ndryshuar. Numri CELEX 32009R0810, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 243, datë 15.9.2009, f. 1–58.

propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR HYRJEN, KALIMIN TRANSIT DHE QËNDRIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

1. Të huajt, që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas përcaktimeve të neneve 6, pika 1, shkronja “e”, dhe 10, pika 2, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, rast pas rasti, mund t’i kërkohet nga autoritetet e kontrollit kufitar në pikat e kalimit kufitar paraqitja e një ose disa dokumenteve të mëposhtme:

- a) Ftesa e garantit/ftuesit në Shqipëri;
- b) Bileta/rezervimi për kthimin;
- c) Çdo lloj dokumenti që vërteton akomodimin e personit;
- ç) Miratimi i punësimit nëse hyn në Shqipëri për motive punësimi;
- d) Mjetet financiare, shqiptare ose valutë e huaj, që mund të shkëmbehen në një agjenci këmbimi në Republikën e Shqipërisë, ose forma të tjera pagese, që pranohen në transaksionet tregtare në Republikën e Shqipërisë, si: çek, kartë krediti etj.;

dh) Dëshmia e mjeteve financiare, si: kontratë llogarie bankare, librezë depozitë etj., qoftë për periudhën e qëndrimit të synuar, ashtu dhe për kthimin në vendin e tij të origjinës ose periudhën kur do të qëndrojnë transit në një shtet të tretë, në të cilin ai është i sigurt që do të pranohet ose provon se është në gjendje të përfitojë mjete të tilla në mënyrë të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë për ditë qëndrimi për të rriturit dhe 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për të miturin;

e) Certifikata e vaksinimit ndërkombëtar, kur i huaji vjen nga vende të prekura nga epidemi ose sëmundje, për të cilat legjislacioni shqiptar e kërkon.

Në rast se i huaji nuk është i pajisur me kartelë, njoftohen strukturat e specializuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të marrë së bashku masat e duhura, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Pas kontrollit të dokumentacionit në pikat e kalimit kufitar apo jashtë tyre, autoritetet kompetente kryejnë këto procedura:



a) Regjistrimin e të huajit kur hyn dhe del në mënyrë të ligjshme nga Republika e Shqipërisë sipas dokumentit të tij të udhëtimit;

b) Regjistrimin e të huajit, të cilit, për arsye të parashikuara në ligj ose në akte nënligjore, i refuzohet hyrja/dalja në/nga territori;

c) Regjistrimin e të huajit, i cili hyn ose ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi për të huajt;

ç) Regjistrimin në dalje të shtetasit të huaj që ka qëndruar në Republikën e Shqipërisë në mënyrë të parregullt ose në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi për të huajt;

d) Regjistrimin e të huajit që kërkon azil, në përputhje me legjislacionin për azilin në Republikën e Shqipërisë;

dh) Evidentimin e masave administrative të vendosura ndaj të huajit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për të huajt, në dalje nga Republika e Shqipërisë.

3. Të huajit të pajisur me leje qëndrimi të përkohshme, i cili qëndron jashtë territorit për një periudhë më shumë se 180 ditë pa ndërprerje, pa njoftuar autoritetin vendor për kufirin dhe migracionin dhe pa dhënë arsye të bazuara në dokumente për pamundësinë e ardhjes, i ndalohej hyrja me këtë leje qëndrimi.

4. Shtetet, shtetasit e të cilave bëjnë përjashtim nga detyrimi i regjistrimit pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku kanë vendosur vendbanimin, përcaktohen në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

## II. KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME VIZË

### A. Kritere të përgjithshme për t'u pajisur me vizë

1. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë me pasaportë diplomatike ose shërbimi, përcaktohen në aneksin nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë me pasaportë të zakonshme ose letërnjoftim, përcaktohen në aneksin nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Përjashtohen nga detyrimi për t'u pajisur me vizë për të hyrë dhe qëndruar në Republikën e Shqipërisë deri në 90 ditë për 180 ditë, për qëllime të barasvlershme me ato të vizës së tipit "C", të

parashikuara në ligjin nr. 79/2021, "Për të huajt", shtetasit e shteteve,;

a) që janë të pajisur me një vizë të vlefshme Shengen me shumë hyrje-dalje, me kushtin që kjo vizë të jetë përdorur më parë në njërin nga shtetet e zonës Shengen apo personat të jenë pajisur me leje të vlefshme qëndrimi në njërin nga shtetet e zonës Shengen;

b) që janë të pajisur me vizë të vlefshme me shumë hyrje-dalje apo leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe e Irlanda e Veriut, me kushtin që vizat të jenë përdorur më parë në këto shtete;

c) që hyjnë dhe qëndrojnë në shtetet e zonës Shengen pa vizë;

ç) që janë të pajisur me leje qëndrimi 10-vjeçare, e lëshuar nga autoritetet e Emirateve të Bashkuara Arabe, e vlefshme jo më pak se një vit nga momenti i hyrjes;

d) anëtarët e ekuipazheve të mjeteve lundruese, të avionëve dhe punonjësit e stafit të trenave.

Përditësimi i listës në anekset nr. 2 dhe nr. 3, për kategorinë e shtetasve sipas shkronjës "c", të pikës 3, të këtij vendimi, hartohet nga autoriteti përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në mënyrë periodike ose në varësi të ndryshimeve që kërkohet të reflektohen dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

4. Shtetet, shtetasit e të cilave hyjnë në Republikën e Shqipërisë me vizë, në përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifave përkatëse të vizave përcaktohen në aneksin nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Tarifave të vizave për të miturit nga moshë 6-12 vjeç janë sa gjysma e tarifave të vizave për të rriturit.

5. Tarifa për vizat nuk zbatohet për:

a) fëmijët deri në moshën 6 vjeç;

b) mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit në respekt dhe zbatim të parimit të reciprocitetit;

c) rastet humanitare;

ç) rastet kur ka marrëveshje reciprociteti në nivel qeverie.

6. Aplikimi për vizë jashtë listës së shteteve të përcaktuara në anekset bashkëlidhur bëhet vetëm me miratim të transferimit të aplikimit nga autoriteti përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.



7. Për të aplikuar për vizë, shtetasi i huaj aplikon *on-line* në sistemin elektronik të vizave ose paraqitet personalisht në konsullatë apo, në rastet e marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe me vende të tjera, në përfaqësitë përkatëse të këtyre vendeve. Shtetasve të huaj pas miratimit të vizës në sistemin elektronik, në rast se kanë aplikuar për vizë elektronike, u gjenerohet kjo e fundit në postën e tyre elektronike. Në rast se kanë aplikuar për vizë pullë, paraqiten fizikisht në përfaqësitë diplomatike.

8. I huaji mund të aplikojë për vizë edhe nga shteti ku është rezident mbi 12 muaj në vendin ku kërkon të aplikojë. Në këto raste, aplikuesi krahas dokumentacionit të kërkuar për aplikim, duhet të paraqesë dhe kopje të lejes së qëndrimit, me vlefshmëri të paktën 3 (tre) muaj më shumë së afati i vizës së kërkuar. Në çdo rast, i huaji mund të aplikojë *on-line* nga çdo vend jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### **B. Dokumentacioni bazë i nevojshëm për të gjitha kategoritë për t'u pajisur me vizë:**

1. Formulari i aplikimit për vizë, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i plotësuar dhe i nënshkruar nga aplikuesi, i cili gjendet *on-line* pa pagesë (formulari plotësohet *on-line* dhe shkarkohet nga sistemi).

2. Fotografia e aplikuesit, e cila duhet të jetë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, e marrë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm.

3. Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, i cili duhet të jetë me vlefshmëri së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar dhe të ketë së paku 2 faqe bosh, në të cilat do të vendoset viza pullë, si dhe fotokopja e faqeve me shënime me interes për udhëtimin.

4. Deklarata sipas përcaktimeve ligjore, ku të shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestarit ligjor sipas legjislacionit në fuqi për udhëtimin e të miturit. Në rast të udhëtimit të një të mituri të pashoqëruar apo të shoqëruar nga njëri prind, duhet të paraqitet një deklaram, me anë të cilit prindi/prindërit ose kujdestari ligjor jep/japin pëlqimin e tij/tyre për hyrjen ose daljen e të miturit nga territori i Republikës së Shqipërisë.

5. Ftesa e nënshkruar nga ana e ftuesit.

a) Ftesës i bashkëlidhet një fotokopje e dokumentit të identifikimit të ftuesit. Në rastin kur ftesa është bërë nga një i huaj me qëndrim në Republikën e Shqipërisë, ftesës i bashkëlidhet dhe fotokopja e lejes së tij të vlefshme të qëndrimit.

b) Përjashtohen nga detyrimi i depozitimit të ftesës aplikuesi për vizë të tipit “C” - turizëm, si dhe i huaji investitor/i punësuar/i vetëpunësuar/punonjës lëvizës digjital në Republikën e Shqipërisë, pensionistë dhe përdorues të pasurisë së paluajtshme në Shqipëri që aplikon për vizë “D”.

#### **C. Dokumentacioni shtesë që kërkohet sipas llojit të vizës, përveç dokumentacionit të përgjithshëm, në varësi të tipit të vizës së kërkuar**

**I huaji duhet të paraqesë edhe dokumentacionin shoqëruar, si më poshtë vijon:**

##### **1. Për vizë të tipit “A”:**

a) fotokopjen e vizës së vendit të destinacionit, nëse është e nevojshme pajisja me vizë për hyrjen në atë vend, ose çdo dokument tjetër e cila provon lidhjen me vendin e destinacionit.

##### **2. Për vizë të tipit “C” - turizëm:**

a) dokumentin e rezervimit vajtje-ardhje të biletës ose të vërtetojë mundësinë e transportit personal;

b) dokumentet në lidhje me rezervimin në një strukturë akomoduese, sipas legjislacionit për turizmin ose ftesë nga personi, fizik apo juridik, ku do të akomodohet;

c) dokumente që tregojnë se kërkuesi zotëron mjete të mjaftueshme financiare për jetesë, si për kohëzgjatjen e qëndrimit dhe për kthimin në vendin e tij të origjinës apo të banimit ose kur qëndron transit në një vend të tretë, në të cilin ai është i sigurt për të hyrë ose që është në gjendje të gëzojë mjete të tilla financiare, të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi;

ç) dokumenti, që vërteton ekzistencën e një marrëdhënieje punësimi të qëndrueshme në vendin e origjinës/qëndrimit. Në mungesë të kësaj marrëdhënieje punësimi, i huaji duhet të vërtetojë se ka interesa për t'u kthyer në vendin e origjinës/qëndrimit.

**2.1 Për vizë të tipit “C” - turizëm, të organizuar në grupe turistike, nëpërmjet paketave të udhëtimit të një operatori turistik shqiptar ose të huaj:**



a) fotokopjen e fletës së pasaportës që tregon hyrjen dhe qëndrimin e ligjshëm të shtetasit të huaj në vendin ku ndodhet në çastin e aplikimit për vizë;

b) fotokopjen e noterizuar të licencës së operatorit turistik shqiptar ose të huaj, si ofruesin e paketës së udhëtimit.

### **2.2 Për vizë të tipit “C” - për motive shkencore, kulturore, sportive dhe humanitare:**

a) ftesën nga subjekti shkencor, kulturor, sportiv apo humanitar vendas, për pjesëmarrjen e të huajit në veprimtarinë për të cilin kërkohet lëshimi i vizës përkatëse;

b) rezervimin e hotelit apo deklaratën e mikpritjes;

c) dokumente që tregojnë se kërkuesi zotëron mjete të mjaftueshme financiare për jetesë, si për kohëzgjatjen e qëndrimit dhe për kthimin në vendin e tij të origjinës apo të banimit ose për kohën kur qëndron transit në një vend të tretë, në të cilin ai është i sigurt për të hyrë ose që është në një pozicion të përfitimit të mjeteve të tilla financiare, të ligjshme në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi;

ç) dokumentin që vërteton realizimin e aktiviteteve shkencore, kulturore, sportive apo humanitare të qëndrueshme në vendin e origjinës të kërkuesit të vizës.

### **2.3 Për vizë të tipit “C” - për motive zyrtare:**

a) ftesën nga institucioni pritës;

b) notën verbale nga institucioni, ku i huaji është i punësuar.

### **2.4 Për vizë të tipit “C” - për motive mjekësore:**

a) konfirmim nga institucioni pritës;

b) epikrizën, kryesisht për diagnozën e lëshuar nga mjeku vendas;

c) deklaratën e institucionit spitalor në Republikën e Shqipërisë, publik apo privat, të licencuar, ku të përcaktohen: lloji i trajtimit mjekësor, data e fillimit dhe përafërsisht kohëzgjatja e trajtimit mjekësor, kostoja e përafërt e trajtimit, si dhe subjekti, që do t'i mbulojë këto kosto;

ç) dokumentet që dëshmojnë ekzistencën e burimeve të nevojshme e të mjaftueshme për të mbuluar pjesën e shpenzimeve shëndetësore, si dhe ato të qëndrimit jashtë strukturës shëndetësore apo të kthimit në atdhe të personit që kurohet e të shoqëruesit të tij;

d) sigurimin shëndetësor në udhëtim të shoqëruesit/shoqëruesve të të sëmurit për të përballuar shpenzimet e nevojshme në rast shtrimi të menjëhershëm, për qëndrimin e tij në Shqipëri, si dhe shpenzimet e kthimit në atdhe.

### **2.5 Për vizë të tipit “C” - për motive profesionale, tregtare dhe biznesi:**

a) ftesën nga subjekti pritës;

b) dokumentin që provon veprimtarinë profesionale, tregtare në vendin përkatës, me të cilin lidhen motivet e vizitës.

### **Për drejtuesit e automjeteve do të kërkohen edhe:**

a) licenca e transportit ndërkombëtar të automjetit (kamionit);

b) leja e qarkullimit ndërkombëtar;

c) dëshmia ndërkombëtare e aftësisë së drejtuesit të automjetit.

### **3. Për vizë të tipit “D”:**

#### **3.1 Dokumentacioni i përgjithshëm:**

a) Ftesa nga subjekti pritës, së bashku me fotokopjen e dokumentit të tij të identifikimit me përjashtim të rastit kur i huaji është investitor/i punësuar/i vetëpunësuar/punonjës lëvizës digjital në Republikën e Shqipërisë, pensionistë dhe përdorues të pasurisë së paluajtshme në Shqipëri që aplikon për vizë “D”;

b) Foto pasaporte me përmasat 5cm x 4cm;

c) Dokumenti që provon veprimtarinë apo aftësinë profesionale, tregtare në vendin e aplikuesit, me të cilin lidhen motivet e kërkesës së vizës së aplikuesit;

ç) Në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit ftues;

d) Dokumenti që vërteton akomodimin në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) Dëshmia e miratimit për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për kategoritë që kanë detyrimin për miratimin paraprak për punësim sipas ligjit për të huajt.

#### **3.2 Dokumentacioni shtesë për vizë për motive të bashkimit familjar (D/BF):**

a) Fotokopja e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar ose fotokopja e dokumentit të identifikimit të të huajit, si dhe e lejes së tij të qëndrimit, të cilët kërkojnë bashkimin familjar me kërkuesin;

b) Certifikata e lëshuar jo më shumë se një muaj para aplikimit për vizë nga autoritetet përkatëse në





vendin e origjinës, e cila vërteton lidhjen e personit, që kërkon bashkim familjar në Shqipëri, ose deklaratë noteriale/marrëveshje noteriale e personave bashkëjetues, ku shprehet bashkëjetesë për më shumë se 12 muaj, shoqëruar me certifikatat personale që vërtetojnë statusin civil pa lidhje martesore të partnerëve;

c) Dokumente të tjera shtesë, si fotografi, filmime etj., që provojnë lidhjen e qëndrueshme me personin, që kërkon bashkim familjar në rast se kërkohet;

ç) Dokumente, që vërtetojnë se pritësi i huaj ka banesë të përshtatshme në Shqipëri dhe plotëson kushtet për banim (fotokopje të noterizuar të kontratës së qirasë apo të një dokumenti që tregon se ka në pronësi një banesë etj.);

d) Fotokopje të noterizuar të dokumentit që vërteton se i huaji pritës është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka sasi të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar jetën e personit/personave që do të vijnë në Republikën e Shqipërisë;

dh) Fotokopje e noterizuar e dokumentit që provon se pritësi i huaj (me banim në Shqipëri) është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka të ardhura të mjaftueshme për të siguruar jetën e personave që ka ftuar dhe që mund të jenë nën përgjegjësinë e tij;

e) Dokument i lëshuar nga institucionet shqiptare apo shteti ku aplikuesi banon, me të cilin provohet se i huaji ka apo ka pasur së paku njërin prind ose gjysh me shtetësi shqiptare.

### **3.3 Dokumentacioni shtesë për vizë për motive për humanitare (D/VHF):**

a) Fotokopje e noterizuar e licencës së ushtrimit të veprimtarive humanitare;

b) Deklaratë për motivin e punës nga organizata humanitare.

### **3.4 Dokumentacioni shtesë për vizë diplomatike ose vizë shërbimi (D/DS):**

a) Nota verbale nga institucioni;

b) Ftesa nga institucioni pritës, kur është e nevojshme.

### **3.5 Dokumentacioni shtesë për vizë për motive studimi (student dhe nxënës) D/ST:**

a) Dokumenti, që vërteton pranimin në një institucion arsimor shqiptar;

b) Dëshmia financiare, që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe të shkollimit;

c) Certifikata që provon njohjen e gjuhës, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë studimet. Prova e njohjes së gjuhës mund të verifikohet edhe me intervistë nga i ngarkuari me çështjet konsullore në ambasadë ose konsullatë.

### **3.6 Dokumentacioni shtesë për vizë për të trajnuarin pa pagesë (D/TPP):**

a) Dokumenti i pranimit në një qendër publike ose private të licencuar për formim profesional;

b) Certifikata që provon njohjen e gjuhës në nivelin fillestar, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë trajnimet.

### **3.7 Dokumentacioni shtesë për vizë për *au pairs* (D/AuP):**

a) Marrëveshja me familjen pritëse ku të jenë detajuar orari i punës, pagesat periodike, pjesëmarrja në kurse;

b) Dëshmia e garancisë financiare nga familja pritëse ose organizata *au pairs*;

c) Certifikata që provon njohjen e gjuhës, me të cilën kërkuesi i vizës do të kryejë aktivitetin. Prova e njohjes së gjuhës mund të verifikohet edhe me intervistë nga i ngarkuari me çështjet konsullore në ambasadë ose konsullatë.

### **3.8 Dokumentacioni shtesë për vizë për shkëmbime rinore (D/SHR):**

a) Vërtetimi nga institucioni ose organizata që i huaji është përfitues i programeve të shkëmbimeve rinore.

### **3.9 Dokumentacioni shtesë për vizë për kërkim shkencor (D/KSH):**

a) Marrëveshje/kontratë e lidhur me një institucion kërkimor shqiptar për qëllime të kërkimit shkencor.

### **3.10 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëmarrës (D/PM)/për të transferuarit brenda ndërmarrjes (D/T):**

a) Deklarata e transferimit brenda ndërmarrjes.

### **3.11 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëtor stinor (D/PS):**

a) Dokumenti, i cili provon regjistrimin e të huajit, që kërkon vizë në institucionet përgjegjëse të punësimit në vendin e origjinës, të njohura sipas marrëveshjeve për punësim sezonal;

b) Një kontratë e vlefshme pune për aktivitet pune stinor, me afat të përcaktuar deri në 6 muaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë;

c) Dokumentacioni që provon akomodimin e punëtorit sezonal.



### 3.12 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për formim profesional (D/FP):

a) Vërtetimi i aftësisë profesionale me të cilin lidhet miratimi i formimit profesional (diplomë, certifikatë, trajnime, kualifikime të ndryshme).

### 3.13 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për sportistë (D/SP):

a) Kontrata e punës me organizatën sportive;

b) Vendimi i gjykatës për regjistrimin e personit juridik ose ekstrakti i regjistrimit në QKB për punëdhënësin/klubin sportiv, ku ai do të punësohet.

### 3.14. Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për shërbim vullnetar (D/SHV):

a) Kontrata që provon veprimtarinë vullnetare dhe subjektin për të cilin do të kryhet.

### 3.15 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për punonjës me kualifikim të lartë (D/KL):

a) Diploma e kualifikimit të arsimit të lartë;

b) Një kontratë e vlefshme pune në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

### 3.16 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për persona të vetëpunësuar (D/VP):

a) Vërtetimi i aftësisë profesionale me të cilin lidhet miratimi i vetëpunësimit (diplomë, certifikatë, trajnime, kualifikime të ndryshme);

b) Dokumenti i statusit juridik të subjektit.

### 3.17 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për punonjës lëvizës digjital (D/LD):

a) Kontratë e vlefshme punësimi me punëdhënësin jashtë shtetit apo kontratë shërbimi me kontraktuesin ose porositësin jashtë shtetit se do të punojë pa një seli konkrete për punë specifike, të cilat lejojnë punën me mjete të teknologjisë së informacionit.

### 3.18 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për investitorë (D/I):

a) Dokumenti që vërteton investime të kryera në vendin e origjinës ose rezidencës ose projekte në zhvillim në Republikën e Shqipërisë.

### 3.19 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për shërbime kontraktuese (D/SHK):

a) Kontratë shërbimi me subjektin e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

b) Vërtetim për kualifikimet përkatëse profesionale që lidhen me ofrimin e shërbimit sipas legjislacionit në fuqi.

### 3.20 Dokumentacioni për vizë tipi “D” për ekuipazhin e mjeteve të lundrimit:

a) Një kontratë e vlefshme pune në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

### 3.21 Dokumentacioni për vizë tipi “D” për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi (D/PPP):

a) Certifikata e pronësisë;

b) Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, për periudhën e kërkuar të qëndrimit;

c) Deklarata individuale mbi motivin e qëndrimit në Shqipëri.

### 3.22 Dokumentacioni për vizë tipi “D” për pensionistët (D/P):

a) Dokument pensioni nga vendi i origjinës ose i rezidencës;

b) Vërtetim i të ardhurave vjetore, minimumi në vlerën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë nga pensioni në shtetin e origjinës.

## III. KRITERET, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËR PAJISJEN ME LEJE QËNDRIMI

### A. Kriteria të përgjithshme dhe procedurat për t'u pajisur me leje qëndrimi

1. Kërkesa për lëshimin e lejes së qëndrimit ose për ripërtëritjen e saj, si dhe miratimi i kërkesës bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt *on-line*.

2. I huaji pajiset me dokumentin biometrik, leje qëndrimi për të huaj, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”. Përfundimisht, lejet e qëndrimit të tipit “A”, të cilat nuk janë biometrike dhe janë të përcaktuara në aneksin nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi. I huaji paraqitet personalisht për aplikimin dhe tërheqjen e dokumentit të lejes së qëndrimit.

3. Vlera e tarifës së shërbimit të lejes së qëndrimit për të huajt përcaktohet në aneksin nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Format i lejes provizore të qëndrimit sipas parashikimeve të nenit 38, të ligjit nr. 79/2021 “Për të huajt”, si dhe formati i lejes humanitare të tipit “A”, është në aneksin nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Formulari standard i aplikimit të lejes unike është në aneksin nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Formularët standardë të aplikimit për lëshimin e lejeve të qëndrimit të kategorive: për



motive të bashkimit familjar, për motive arsimit, trajnimit, kërkimi shkencor, për raste humanitare, për qëndrim të përhershëm dhe për kategori të veçanta, janë në aneksin nr. 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Përjashtohen nga pagesa e tarifës së shërbimit për pajisjen me leje qëndrimi shtetasit e Republikës së Kosovës dhe shtetasit e përkatësive etnike shqiptare të republikave të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, që qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë për qëllime studimi. Shtetasi aplikues ka detyrimin të paguajë vetëm vlerën e dokumentit biometrik, leje qëndrimi.

8. Për disa kategori të të huajve, pagesat për pajisje me leje qëndrimi janë, si më poshtë vijon:

a) Për të huajt, që punojnë në organizata dhe shoqata jofitimprurëse, bamirëse, humanitare, fondacione dhe shoqata fetare, në bazë të parashikimeve në marrëveshje ndërkombëtare dypalëshe të lidhura me shtetin shqiptar për përjashtimin nga taksat, është falas vetëm tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi, ndërsa vlera e dokumentit biometrik, leje qëndrimi, do të përballohet nga vetë personi;

b) Për kategoritë e përcaktuara në nenet 43, 52, 53 dhe 87, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas, ndërsa vlera e dokumentit biometrik, leje qëndrimi, mbulohet nga buxheti i autoritetit shtetëror që trajton këto kategori;

c) Për kategoritë që, në bazë të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, përfitojnë leje qëndrimi tipi “A”, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas ndërsa formati i lejes së qëndrimit është sipas aneksit nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Për të huajt në moshë të mitur nën 16 vjeç, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas, ndërsa vlera e dokumentit biometrik, leje qëndrimi, do të përballohet nga vetë personi;

d) Për të huajt që me marrëveshje qeveritare është parashikuar reciprocitet në heqjen e tarifave të shërbimit, tarifa e shërbimit të pajisjes me leje qëndrimi është falas, ndërsa vlera e dokumentit biometrik, leje qëndrimi, do të përballohet nga vetë personi.

9. Dokumentacioni nga vendi i origjinës dhe/ose nga vendi ku i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe,

i vërtetuar dhe i legalizuar në bazë të detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare.

10. Dëshmi të burimeve të mjaftueshme financiare për jetesën në Republikën e Shqipërisë, e cila konsiston në paraqitjen e një vërtetimi depozite bankare në bankat e nivelit të dytë, personale apo familjare.

11. I huaji, që ka përfituar leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë, mund të aplikojë për ripërtëritjen e saj për një motiv të ndryshëm nga motivi i lejes paraardhëse, me kusht që:

a) të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim për motivin e kërkuar;

b) afati i lejes së qëndrimit të mos jetë më shumë se 1 (një) vit.

Nëse i huaji kërkon të ndryshojë motivin e lejes së qëndrimit, brenda afatit të vlefshmërisë së lejes (me përjashtim të lejes për herë të parë), ai mund të aplikojë për një leje të re qëndrimi me afat jo më shumë se 1 vit, pas dorëzimit të lejes së vlefshme të qëndrimit pranë autoritetit vendor për kufirin dhe migracionin dhe plotësimin të kushteve të përmendura në shkronjat “a” e “b” të kësaj pike.

### **B. Dokumentacioni i përgjithshëm dhe i nevojshëm për të gjitha llojet e lejeve të qëndrimit**

Për t'u pajisur me leje qëndrimi, i huaji depoziton edhe *on-line* këto dokumente:

1. Formularin e aplikimit për lëshimin e lejes së qëndrimit përkatësisht të plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi, sipas modeleve të përcaktuara në anekset nr. 8 dhe nr. 9, që i bashkëlidhen këtij vendimi, i cili gjendet *on-line* pa pagesë, fotografi të aplikuesit, të bëra jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuara dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

2. Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me të cilin i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe fotokopjen e faqeve me shënime me interes për udhëtimin, si dhe gjenealogjetet e mbajtësit, viza e tipit “D”, vulat në hyrje-dalje.

3. Dokumentet që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri.

4. Kontratën e blerjes ose të marrjes me qira të banesës, në përputhje me standardet e banimit në



Shqipëri ose çdo dokument tjetër që provon strehimin e garantuar në Republikën e Shqipërisë.

**C. Dokumentacioni shtesë sipas llojit të lejes së qëndrimit të përkohshme:**

**1. Dokumentacioni shtesë për motive të bashkimit familjar:**

**a. Dokumentacioni shtesë për motive bashkim familjar me shtetas shqiptar:**

i. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar;

ii. Certifikata familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

iii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme vetëm për ftuesit e huaj për përballimin e jetesës brenda standardeve në Shqipëri, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike (vetëm për bashkim familjar për partnerë civilë);

iv. Deklarata noteriale për bashkëjetesë për bashkim familjar për partnerë civilë;

v. Dokumenti ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër kur kërkohet bashkimi familjar vetëm i të miturit/miturve;

vi. Dokumenti që vërteton se ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij për të cilën kërkon bashkim familjar.

**b. Dokumentacioni shtesë për motive bashkim familjar me shtetas të huaj:**

i. Fotokopja e lejes së qëndrimit të familjarit ftues (në rastin kur ftuesi është shtetas i huaj);

ii. Certifikata familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

iii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme vetëm për ftuesit e huaj për përballimin e jetesës brenda standardeve në Shqipëri, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike;

iv. Deklarata noteriale për bashkëjetesë;

v. Dokumenti ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër kur kërkohet bashkimi familjar vetëm i të miturit/miturve;

vi. Dokument që vërteton se ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij për të cilën kërkon bashkim familjar.

**2. Dokumentacioni shtesë për pajisjen me leje për motive arsimit, trajnimit, kërkimi shkencor**

**a. Dokumentacioni shtesë për motive studimi (student dhe nxënës):**

i. Dokumenti i pranimit nga një institucion arsimor në Shqipëri;

ii. Dëshmia e burimeve të mjaftueshme financiare për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar;

iii. Dëshmia e njohjes së gjuhës të programit të studimit/gjuhës së zhvillimit të procesit mësimor apo vërtetim për pranimin në kursin përgatitor të gjuhës;

iv. Dokument se janë paguar tarifat e vendosura nga institucioni i arsimit të lartë.

**b. Dokumente shtesë për nxënës:**

i. Dëshmi se nuk është nën moshën ose nën klasën minimale dhe as mbi moshën ose klasën maksimale të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar;

ii. Dëshmi se nxënësi i huaj do të akomodohet nga një familje gjatë gjithë qëndrimit të tij në një ambient të veçantë akomodimi brenda institucionit arsimor ose në ndonjë ambient tjetër që përmbush kushtet e duhura.

**c. Dokumentacioni shtesë për të trajnuarin pa pagesë:**

i. Dokumenti i pranimit nga një institucion që do të zhvillojë trajnimin, ku të përfshihet kualifikimi që do të përftohet dhe kohëzgjatja;

ii. Dëshmia e burimeve të mjaftueshme financiare për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar.

**ç. Dokumentacioni shtesë për *au pairs*:**

i. Marrëveshje me familjen pritëse ku të parashikohet në veçanti mbulimi i shpenzimeve të jetesës, akomodimit dhe rreziqet nga aksidentet;

ii. Dëshmi e nivelit të arsimit të mesëm dhe/ose të lartë ose kualifikimit profesional;

iii. Certifikata që provon njohjen e gjuhës. Prova e njohjes së gjuhës mund të verifikohet edhe me intervistë nga i ngarkuari me çështjet konsullore në ambasadë ose konsullatë.

**d. Dokumentacioni shtesë për shkëmbime rinore:**

i. Dokumenti i pranimit nga një organizatë që ka veprimtari shkëmbime rinore në Shqipëri;

ii. Dëshmia e burimeve të mjaftueshme financiare për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar.

**dh. Dokumentacioni shtesë për kërkim shkencor:**

i. Fotokopja e marrëveshjes së nënshkruar me organizatën kërkimore-shkencore apo institucionin e arsimit të lartë në Shqipëri;



ii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar.

**e. Dokumentacioni shtesë për kërkimin e punës ose sipërmarrjen për kërkuesit shkencorë dhe studentët:**

i. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për jetesë gjatë qëndrimit në Shqipëri për periudhën e kërkuar;

ii. Dëshmia se kanë një nivel arsimimi që nuk duhet të jetë më i lartë se niveli 7 i Kornizës Evropiane të Kualifikimeve;

iii. Dëshmia nga organizata kërkimore për përfundimin e veprimtarisë kërkimore (për kërkues shkencorë) ose dëshmia se zotërojnë një diplomë të arsimit të lartë (për studentë), certifikatë ose prova të tjera të kualifikimeve zyrtare.

**ë. Dokumentacioni shtesë për raste humanitare tipi “A”:**

Përveç fotokopjes së një dokumenti identifikues nëse e posedon, shtetasi i huaj duhet të dorëzojë sipas motivit një nga dokumentet e mëposhtme:

i. Kërkesën nga autoritetet përgjegjëse që trajtojnë të huajin për pajisje me leje qëndrimi, ku përcaktohet statusi ose parashtrahet arsyeja për çdo rast; ose

ii. Dëshminë se ka qenë subjekt i kushteve të punës shfrytëzuese në Republikën e Shqipërisë se bashkëpunon në një proces penal kundër punëdhënësit, deri në përfundimin e procesit, dhe të ketë marrë shumën e dëmshpërblimit të tij që përcaktohet nga procesi; ose

iii. Dëshminë se ka bashkëpunuar ose pranon të bashkëpunojë me organet e drejtësisë, me propozim të organeve shtetërore ose të atyre të sigurisë kombëtare; ose

iv. Vërtetimin nga autoritetet përgjegjëse se është person pa shtetësi; ose

v. Dokumentin se është i kategorizuar si i mitur i braktisur ose ka mbetur pa mbrojtje prindërore, kujdestari apo shoqëruar për arsye të tjera; ose

vi. Vërtetimin e shtatzënisë deri në muajin e 6; ose

vii. Dëshminë për personat e sëmurë rëndë që nuk mund të trajtohen në vendin e kthimit; ose

viii. Një kërkesë për të qëndruar sepse është larguar nga vendi i tij për shkak të katastrofave/ngjarjeve natyrore; ose

ix. Kopje të marrëveshjes ndërkombëtare referuese ku përcaktohet motivi i qëndrimit.

**f. Dokumentacioni shtesë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore:**

i. Fotokopja e dokumentit të udhëtimit (nëse i huaji e ka);

ii. Kërkesa nga autoritetet përgjegjëse që trajtojnë të huajin për pajisje me leje qëndrimi, ku përcaktohet statusi ose parashtrahet arsyeja për çdo rast.

**g. Dokumentacioni shtesë për personat pa shtetësi:**

i. Fotokopja e dokumentit të udhëtimit (nëse i huaji e ka);

ii. Dëshmia nga autoritetet kompetente mbi statusin e personit pa shtetësi.

**Ç. Procedura e përgjithshme për t'u pajisur me leje unike, sipas skemës, pjesë përbërëse të vendimit**

1. Aplikimi për leje unike bëhet përmes sistemit elektronik të sigurt *on-line*. Në momentin e përfundimit të aplikimit të huajt i dërgohet një njoftim *on-line* për pranimin e aplikimit.

2. Aplikimi për lejen unike bëhet nga vetë i huaji, nga punëdhënësi i tij, personi i autorizuar nga i huaji.

3. I huaji mund të aplikojë nga shteti, në të cilin ka rezidencën, ose nga territori i Republikës së Shqipërisë kur i huaji ka qëndrim të rregullt.

4. Autoriteti për marrjen e aplikimit dhe lëshimin e lejes unike është autoriteti i kufirit dhe migracionit.

5. Për kategoritë e të huajve, të cilat në bazë të ligjit duhet të marrin miratimin e punësisimit, aplikimi shqyrtohet dhe aprovohet *on-line* fillimisht nga AKPA-ja.

6. Për kategorinë e të huajve të vetëpunësuar dhe investitorë, vlerësimi i plotësisimit të kushteve për pajisjen me leje unike bëhet nga komisioni vlerësues i ministrisë përgjegjëse për financat dhe ekonominë.

7. Për kategoritë e të huajve, të cilët, në bazë të ligjit kanë nevojë të pajisen me vizë, viza miratohet nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme pasi të jetë aprovuar miratimi i punësisimit nga AKPA-ja.

8. Pas miratimit të punësisimit nga AKPA-ja dhe miratimit të vizës nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, autoriteti për kufirin dhe migracionin merr vendimin për lëshimin, ndryshimin ose ripërtëritjen e lejes unike, nëse aplikuesi përmbush kushtet e specifikuar në ligj.



Për kategoritë që nuk kanë nevojë për miratim punësimi dhe miratim vize, aplikimi bëhet direkt te struktura përgjegjëse për çështjet e kufirit dhe migracionit.

9. Shqyrtimi i kërkesës dhe lëshimi i lejes unike të qëndrimit, kur plotësohen kriteret e kërkuara nga legjislacioni në fuqi, bëhen brenda një afati maksimal prej 12 javësh nga dita e aplikimit. Shqyrtimi i kërkesës nga secili institucion përgjegjës duhet bërë brenda një afati maksimal prej 2 javësh. Miratimi apo refuzimi i kërkesës i njoftohet *on-line*.

10. Procedurat e bashkëpunimit për sistemin elektronik *on-line* miratohen me udhëzim të ministrave përgjegjës respektiv.

**D. Dokumentacioni shtesë për t'u pajisur me leje unike:**

**a. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëmarrës:**

i. Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënës, në përputhje me formimin e tij profesional (kontrata e punës duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë për këtë dokument), ose kategorizimi si punëkërkues, në përputhje me marrëveshje reciproke ndërqeveritare.

ii. Dëshmi aftësimi (diploma/certifikata/referenca) ose vetëdeklarim për eksperiencën në punë) që vërteton aftësitë profesionale në përputhje me punën që do të kryejë sipas kontratës së punës.

**b. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëtor stinor:**

i. Kontrata e punës si punëmarrës stinor me një punëdhënës, me një afat të përcaktuar deri në 6 muaj, në përputhje me formimin e tij profesional; (kontrata e punës duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë për këtë dokument);

ii. Në rast se kontrata/oferta e punës e të huajt përcakton se aktiviteti që do të ushtrojë është një profesion i rregulluar, i huajt duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në përputhje me të drejtën kombëtare të ushtrimit të profesioneve të rregulluara. Emërtimi i profesionit në dokument duhet të jetë në përputhje me Listën Kombëtare të Profesioneve ose me të njëjtat aftësi të përcaktuara nga ESCO-ja.

**c. Dokumentacioni shtesë për leje unike si i transferuar brenda ndërmarrjes (TBN):**

i. Deklaratë e transferimit brenda ndërmarrjes;

ii. Dokument (kontratë pune) ndërmjet punonjësit dhe ndërmarrjes dërguese, në të cilën specifikohen pozicioni i punës, aktivitetet që do të kryhen dhe elementet e tjera të kontratës së punës, sipas legjislacionit shqiptar.

**ç. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëtor ndërkufitar:**

iii. Kontrata e punës e lidhur me punëdhënësin nëse është me statusin e punëmarrësit ose dokumentacion për statusin e tij si punëdhënës/i vetëpunësuar;

iv. Dokumentacioni që vërteton se punëdhënësi e ka punësuar në kuadër të një marrëveshjeje (nëse ka);

v. Dokumentacioni që i huajt provon se ka vendbanim në një zonë gjeografike kufitare të territorit të Republikës së Shqipërisë.

**d. Dokumentacioni shtesë për leje unike për formim profesional:**

i. Vërtetimi i regjistrimit në kursin e formimit profesional, lëshuar nga subjekti, ofrues i formimit;

ii. Dokumenti për llogarinë bankare, në vlerën e pagës minimale mujore, për kohën e kryerjes së kursit (për të vërtetuar mundësinë e përballimit të jetesës).

**dh. Dokumentacioni shtesë për leje unike për sportistë:**

vi. Vendimi i gjykatës për regjistrimin e personit juridik ose ekstrakti i regjistrimit në QKB për punëdhënësin/klubin sportiv, ku ai do të punësohet;

vii. Kontrata e punës e lidhur me punëdhënësin në përputhje me profesionin e tij si sportist.

**e. Dokumentacioni shtesë për leje unike për shërbime vullnetare:**

viii. Marrëveshja me organizatën jofitimprurëse, që ofron shërbime bamirësie në territorin e Republikës së Shqipërisë për të huajt, që do të shërbejnë vullnetarisht;

ix. Burimet e disponueshme për të mbuluar kostot e jetesës, strehimit dhe një shumë minimale/"para xhepi" përgjatë qëndrimit, sipas standardit të minimumit jetik;

x. Kontrata e vullnetarizmit.

**ë. Dokumentacioni shtesë për leje unike për punonjës me kualifikim të lartë:**

xi. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

xii. Kontrata e vlefshme pune me një punëdhënës, për punësim me kualifikim të lartë, në



përputhje me formimin e tij profesional, me kohëzgjatje së paku 1-vjeçare në Republikën e Shqipërisë, ku disponon dëshminë e kualifikimit të lartë profesional mbi nivelin e 4 (katërt) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

xiii. Dokumenti që vërteton kualifikimet e larta profesionale përkatëse në profesionin/pozicionin e punës apo sektorin e specifikuar në kontratën e punës për profesionet e parregulluara.

**f. Dokumentacioni i veçantë për leje unike për shërbime kontraktuese:**

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

ii. Miratimi për punësim për shërbime kontraktuese.

**g. Dokumentacioni shtesë për leje unike për të vetëpunësuar:**

**Unë kam bashkëngjitur vërtetimet e mëposhtme se bashku me aplikimin/I am enclosing the following clarifications with my application:**

- Dëshmi të aseteve / Certificate of the assets
- Fitimet kapitale nga këto asete / The capital gains from these assets

**Nëse ka disa burime të ardhurash, deklarojini të gjitha. / If there are several sources of income, declare all of them.**

Unë jam pensionist dhe kam bashkëngjitur vërtetimin e pensionit me aplikimin / I'm a pensioner and I'm enclosing a pension decision with my application .



Unë kam te ardhura te cilat nuk janë përmendur me lart: / I have an income which is none of the above:

Nëse keni ndonjë arsye tjetër për të qëndrimit tuaj në Shqipëri përveç këtyre të dhëna në titullin e këtij formulari, ose në qoftë se qëndrimi juaj në Shqipëri, ka disa qëllime të tjera përveç atij që ju kanë dhënë më lart dhe që ju dëshironi për t'iu referuar, ose nëse ju dëshironi për të komunikuar disa informata të tjera për autoritetet në lidhje me aplikimin tuaj apo qëndrimit tuaj në Shqipëri, shkruani këtë informacion këtu.

If you have any grounds for your residence in Albania other than those given in the title of this form, or if your residence in Albania has some other purpose in addition to the one you have given above and that you wish to refer to, or if you wish to communicate some other information to the authorities related to your application or your residence in Albania, enter that information here.

### SEKSIONI C / SECTION C

#### 4 Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application

keni qenë ndonjëherë i dënuar për një vepër penale dhe sa jeni dënuar?  
Have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?

Jo/ No

Po, specifiko vepren penale dhe sa jeni denuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment


vuani nga ndonjë sëmundje? / Do you suffer from any diseases?

Jo/ No

Po, specifiko semundjen: / Yes, specify the disease:

### SEKSIONI D / SECTION D

#### 5 Deklarime perfundimtare / Last declarations



Unë po aplikoj për një leje qëndrimi në Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj, konfirmoj me nënshkrimin tim që informacioni i paraqitur në këtë aplikim dhe shtojcat e tij janë korrekte dhe të sakta. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacioni të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e lejes së qëndrimit ose të heqjes së lejes ekzistuese, riatdhesimi dhe



**refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë.**

I am applying for a Albanian residence permit and hereby affirm with my signature that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory.

**Vendi dhe data**  
Place and date

**Nënshkrimi**  
Signature

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Emri ne shkronja kapitale** Name in block letters

**Nënshkrimi i fëmijës nëse është mbi 18 vjeç :**

Signature of the child if aged 18 or more :

Name in block letters

\_\_\_\_\_ /

**Emri ne shkronja kapitale** /

**SEKSIONI E / SECTION E**

**6 Shtojca të detyrueshme / Obligatory appendices**

Me poshtë janë listuar sqarimet e nevojshme si shtojcat ne këtë aplikim për leje qëndrimi. Me dorëzimin e aplikimit duhet te paraqiten çertifikata origjinale dhe deklarata, nëse nuk janë ne gjuhen shqipe, duhet te përkthehen nga përkthyes te autorizuar dhe te legalizohen sipas marrëveshjeve ndërmjet shteteve.

The clarifications listed below are required as appendices to this residence permit application. The original certificates and clarifications must be presented when submitting the application; if they are not in Albanian, they must be translated by an authorized translator and must be legalized .

**Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.**  
Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

**Fotokopja e dokumentit te vlefshëm te udhëtimit (origjinali të paraqitet, kur dorëzon kërkesën për leje qëndrimi)**

Photocopy of valid travel document (the original must be presented when submitting the residence permit application)





- Dy fotografi (47mmX36mm) te bëra jo me përpara se 6 muaj nga data e aplikimit  
Passport photo (47mmX36mm)
- Për një fëmijë të mitur, deklaratën noteriale me shkrim nga prindi i cili nuk është personi i paraqitjes së kërkesës  
For an underage child, written consent from the parent who is not the person submitting the application
- Sqarim për akomodimin (dokumentacionet të përmendura në pikën 2.3)  
Clarification of accommodation (documentation referred to in point 2.3)
- Dëshmi penaliteti (ne Shqipëri)  
Criminal record (in Albania)
- Sqarim i të ardhurave dhe sigurimit shëndetësor (dokumentacione apo sqarime të përmendura në pikën B/VI)  
Clarification of income source and health insurance (documentation or clarification referred to in point B/VI)

### SEKSIONI F / SECTION F

**7 Për tu plotësuar nga zyrtari që pranon aplikimin**  
To be filled out by the official person to whom the application was submitted

Tipi i lejes që përfitohet:  KARTA C  KARTA-BLU-AL-C

\_\_\_\_\_, më: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi i  
zyrtarit: \_\_\_\_\_

Për kategori të veçanta:



REPUBLIKA E  
SHQIPËRISË

KARTA B ID \_\_\_\_\_  
KARTA S  
Punësim  
stinor  
Trajnuar pa  
pagese  
Shërbime  
vullnetare  
Shkëmbime  
rinore

### APLIKIM PER LEJE QENDRIMI / RESIDENCE PERMIT APPLICATION

Ky formular është për të aplikuar për leje qëndrimi Republikën e Shqipërisë. Plotësoni me kujdes dhe nënshkruani aplikimin. Informacioni jo i plotë do të vonojë përpunimin e aplikimit dhe mund të çojë në refuzimin e tij. Aplikimi mund të paraqitet në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit në Shqipëri, ku ju keni vendbanimin.



**Lexoni udhëzimet për plotësimin e formularit në [www.asp.gov.al](http://www.asp.gov.al) → English → Application forms. Sqarimet që ju duhet të bashkëlidhni në aplikimin tuaj janë të shënuara në seksionin E të këtij formulari.**

This form is for applying for a Albanian residence permit. Carefully fill in and sign the application. Incomplete information will delay the processing of the application and may lead to its rejection. An application may be submitted to the Regional Directorate of Border and Migration in Albania, where is your residence. Read the instructions for filling in the form at [www.asp.gov.al](http://www.asp.gov.al) → English → Application forms. Clarifications that you need to append to your application are listed in Section E of this form.

Unë po aplikoj për  leje qendrimi për herë të parë   
 rinovim leje qendrimi I am applying for a first residence permit  
 renewed residence permit

**dhe në këtë mënyrë po paraqes informacionin e mëposhtëm për përpunimin e aplikimit tim:**

*and hereby submit the following information for the processing of my application:*

## SEKSIONI A / SECTION A

<b>1 Informacion mbi aplikantin / Information on applicant</b>			
<b>1.1 Informacion mbi pasaportën ose dokumentin e udhëtimit</b>			
<b>Information on Passport or travel document</b>			
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportës: / Passport no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportës Shërbimi /Official passport no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Dokumentit të udhëtimit refugjati / Refugee's travel document no.		
<input type="checkbox"/>	Numri i Pasaportë për te huajt / Alien's passport no.		
<input type="checkbox"/>	Dokument tjetër, specifikoj llojin dhe Numrin / Other, specify type and no.		
<b>Vendi i lëshimit</b> Country of issue	<b>Autoriteti i lëshimit</b> Authority of issue	<b>Data e lëshimit</b> Date of issue	<b>Data e skadimit</b> Date of expiry



1.2 Te dhëna personale / Personal data			
Mbiemri / Family name		Emrat / First names	
Emri i nënës Mother's name		Emri i babait Father's name	
Datëlindja (dd.mm.yyyy) Date of birth		ID Numri Personal në Shqipëri (nëse ka) Albanian personal identity number (if applicable)	
Shteti i lindjes Country of birth		Vendi i lindjes / Place of birth	
Gjinia /Gender: <input type="checkbox"/> Mashkull / Male <input type="checkbox"/> Femër / Female <input type="checkbox"/> E panjohur / Unknown			
Shtetësia (të) / Current citizenship(s)			
Gjendja Civile / Civil status <input type="checkbox"/> Martuar / Married <input type="checkbox"/> Beqar / Single <input type="checkbox"/> Divorcuar / Divorced <input type="checkbox"/> I(e) Ve / Widow(er) <input type="checkbox"/> Partner Civil / Civil Partner			
Profesioni dhe /ose trajnimi: Occupation and/or training:		Gjuha mëmë: Mother Tongue:	
<p><b>1.3 Informacioni i kontaktit të aplikantit / Contact Information of Applicant</b>  Nëse informacioni i kontaktit ndryshon, njoftoni menjëherë autoritetin që ka pranuar aplikimin tuaj.  If your contact information changes, immediately notify the authority that received your application.</p>			
Adresa 1 / Address 1		Adresa 2/	
Address 2		Adresa 2/ Address 2	
Rruga, Nr. Street, No.			
Fshati/Qyteti - Shteti City/Town - Country			
Tel. /Cel./Fax			
E-mail			
<p><b>2 Informacion mbi anëtarët e familjes / Information on family members</b>  <b>2.1 Bashkëshorti ose Partneri civil/ Spouse or civil partner</b> <input type="checkbox"/> I  pamartuar /No spouse</p>			



<b>Mbiemri / Family name :</b>		<b>Emrat / First names:</b>	
<b>Datëlindja (dd.mm.yyyy)</b> Date of birth		<b>Id Personal në Shqipëri (nëse ka)</b> Albanian personal identity number (if applicable)	
<b>Shtetësia (te) aktuale</b> Current citizenship(s)			
<b>Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati)</b> Address (street, no, city/country)			
<b>2.2 Fëmijë të mitur në kujdestari / Underage in my care</b> fëmijë në kujdestari in my care		<input type="checkbox"/> <b>Nuk kam</b> No children	
<p><b>Ju lutemi deklaroni te gjithë fëmijët ne kujdestari pavarësisht nëse ju po aplikoni për leje qëndrimi Shqiptare për ta ose jo. Nëse leja e qëndrimit te përhershme kërkohet për një fëmije, duhet te plotësohet një formular aplikimi i veçante për të.</b></p> <p>Please declare all your underage children regardless of whether you are applying for a Albanian residence permit for them or not. If a permanent residence permit is being sought for a child, a separate application form must be filled in for him/her.</p>			
<b>Emri / First name</b> Datëlindja (ddmmYYYY) Date of birth	<b>Mbiemri /Family name</b>		
	<input type="checkbox"/> <b>Aplikim njëkohësisht</b> Simultaneous Application		
	<input type="checkbox"/> <b>Aplikim njëkohësisht</b> Simultaneous Application		
	<input type="checkbox"/> <b>Aplikim njëkohësisht</b> Simultaneous Application		
	<input type="checkbox"/> <b>Aplikim njëkohësisht</b> Simultaneous Application		
	<input type="checkbox"/> <b>Aplikim</b>		



<b>njëkohësisht Simultaneous Application</b>
<b>Nëse keni me shumë se pesë fëmijë, futni informacionin e fëmijëve të mbetur në një aneks të veçantë</b> If you have more than five children, enclose the information on the remaining children in a separate appendix.
<b>2.3 Banesa / Residence</b>
<b>Ambjenti i banimit:</b> <input type="checkbox"/> Garsonierë <input type="checkbox"/> Ambient kolektiv, pensione /hotel <input type="checkbox"/> Apartament me dhoma Place of residence: Studio apartments Collective accommodation/hotel Apartment with rooms
<b>Unë kam bashkëngjitur kontratën e qerasë / dëshminë e pronësisë së bashku me aplikimin</b> I am enclosing with the application the rent contract / proof of property

**SEKSIONI B / SECTION B**

<b>3. Informacion mbi qendrimin në Shqipëri / Information on residence in Albania</b> <b>3.1 Arsyet e qendrimit/ Grounds for residence</b>
<b>Kur dhe në cilin PKK keni hyrë në Shqipëri (dd.mm.yyyy)? / When and in which BCP did you enter to Albania ?</b> <b>Datë/Date:                      PKK/ BCP:</b>
<b>Cilat janë arsyet e qëndrimit tuaj në Shqipëri? / What are the grounds for your residence in Albania?</b>  <input type="checkbox"/> I punësuar stinor / Seasonal Employed <input type="checkbox"/> Shkembime Rinore / Vullnetare / Youth / Volunteering exchange <input type="checkbox"/> Kerkime shkencore / Scientific Research
<b>3.2 Afati i qëndrimit / Terms of stay</b>
<b>Unë aplikoj për leje qendrimi me afat / I'am applying for a permit term:</b> Shëno Afatin:
<b>3.3 Informacion mbi ftuesin / Information on host</b>
<b>Informacion mbi organizatat homologe ne Shqiperi / Information on homologue organisations in Albania</b>  <input type="checkbox"/> Organizate jo Qeveritare / Ungovernmental Organization



<input type="checkbox"/> <b>Institucion / Institution</b>				
<b>Emertimi i biznesit / institucionit, kodi fiskal:</b> Name of business/institution business, identity code:				
<b>Adresa (rruga, nr, qyteti/ fshati, shteti):</b> Address (street address, no, city/town, country):				
<b>Tel. :</b>		<b>E-mail:</b>		
<b>Afatet dhe kushtet e punësimit : / Terms and conditions of employment:</b>				
<input type="checkbox"/> <b>pune</b> <b>Employment Certification Statement</b>		<input type="checkbox"/> <b>Leje Pune</b> <b>Vertetim Deklarim punësimi</b> <b>Work Permit</b>		<input type="checkbox"/> <b>Çertifikate regjistrimi</b> <b>Work registration certificate</b>
<b>Kodi dokumentit:</b> Document Code:		<b>Fillon / Bigins</b> (dd.mm.y yyy)		<b>Mbaron / Ends</b> (dd.mm. yyyy)
<b>3.4 Te ardhurat dhe sigurimi shëndetësor / Incomes and health insurance</b>				
<b>Te ardhurat dhe sigurimi shendetesor/ Incomes and health insurance</b> <b>Une kam bashkengjitur vertetimet e meposhtme sebashku me aplikimin:</b> <b>I am enclosing the following clarifications with my application:</b>				
<input type="checkbox"/> <b>Fotokopje te marrevshjes ose te kontratës se punësimit me institucionin/ Copy of agreement or employment contract</b>				
<input type="checkbox"/> <b>Dëshmi te burimeve financiare (Gjendja e llogarisë bankare) / Proof of financial resources (Bank statements certificate)</b>				
<input type="checkbox"/> <b>Vertetim te sigurimeve shendetesore për periudhën e punësimit / Health insurance certificate for terms of employment</b>				



### SEKSIONI C / SECTION C

#### 4 Informacion plotësues për Aplikimin / Additional information for the application

**keni qenë ndonjëherë i dënuar për një vepër penale dhe sa jeni dënuar?**  
 have you ever been convicted of an offence and sentenced to punishment?

Jo/ No

Po, specifiko vepren penale dhe sa jeni denuar / Yes, specify the offence and sentenced to punishment

**vuani nga ndonjë sëmundje?**

Do you suffer from any diseases?

Jo/ No

Po, specifiko semundjen: / Yes, specify the disease:

### SEKSIONI D / SECTION D

#### 5 Deklarime perfundimtare / Last declarations

Foto  
Photo

**Unë po aplikoj për një leje qëndrimi ne Shqipëri dhe nëpërmjet kësaj, konfirmoj me nënshkrimin tim që informacioni i paraqitur në këtë aplikim dhe shtojcat e tij janë korrekte dhe te sakta. Unë jam i vetëdijshëm se duke u dorëzuar autoriteteve dokumentacioni të rremë dhe informacion personal të rremë me shkrim, është një vepër e dënueshme sipas Kodit Penal në Shqipëri dhe se informacioni i rremë mund të çojë në refuzimin e lejes së qëndrimit ose të heqjes së lejes ekzistuese, riatdhesimi dhe refuzimin e hyrjes në territorin e Shqipërisë.**

I am applying for a Albanian residence permit and hereby affirm with my signature that the information I submit in this application and its appendices is correct and accurate. I am aware that providing false personal information and false written documentation to the authorities is an act punishable under the Penal Code in Albania and that providing false information may lead to a refusal of a residence permit or the cancelling of an existing permit, repatriation and the refusal of entry into the Albanian territory.



<b>Vendi dhe data</b> Place and date	<b>Nënshkrimi</b> Signature
_____	_____
_____	<b>Emri ne shkronja kapitale</b> Name in block letters

## SEKSIONI E / SECTION E

### 6 Shtojca të detyrueshme / Obligatory appendices

Me poshtë janë listuar sqarimet e nevojshme si shtojcat ne këtë aplikim për leje qëndrimi. Me dorëzimin e aplikimit duhet te paraqiten çertifikata origjinale dhe deklarata, nëse nuk janë ne gjuhen shqipe, duhet te përkthehen nga përkthyes te autorizuar dhe te legalizohen sipas marrëveshjeve ndërmjet shteteve.

The clarifications listed below are required as appendices to this residence permit application. The original certificates and clarifications must be presented when submitting the application; if they are not in Albanian, they must be translated by an authorized translator and must be legalized .

**Bashkëngjitni sqarimet me aplikimin dhe shënoni kutitë poshtë si të përshtatshme.**  
Enclose the clarifications with the application and tick the boxes below as appropriate.

**Fotokopja e dokumentit te vlefshëm te udhëtimit (origjinali të paraqitet, kur dorëzon kërkesën për leje qëndrimi)**

Photocopy of valid travel document (the original must be presented when submitting the residence permit application)

**Dy fotografi (47mmX36mm) te bëra jo me përpara se 6 muaj nga data e aplikimit**

Passport photo (47mmX36mm),

**Sqarim për akomodimin (dokumentacionet të përmendura në pikën 2.3)**

Clarification of accommodation (documentation referred to in point 2.3)

**Dëshmi penaliteti (aplikimet për here të parë )**

Criminal record (first resident permit)

**Sqarim i të ardhurave dhe sigurimit shëndetësor (dokumentacione apo sqarime të përmendura në pikën 3/4)**

Clarification of income source and health insurance (documentation or clarification referred to in point 3/4)



**SEKSIONI F / SECTION F****7 Për tu plotësuar nga zyrtari qe pranon aplikimin****To be filled out by the official person to whom the application was submitted**


Tipi i lejes që përfitohet:

- KARTA S                      afati: \_\_\_\_\_ muaj  
 KARTA B                      afati: \_\_\_\_\_ muaj

\_\_\_\_\_, më: \_\_\_\_\_ Nënshkrimi i  
zyrtarit: \_\_\_\_\_




**Skema logjike operacionale  
LEJE UNIKE me VIZE D**





**Skema logjike operationale**  
**LEJE UNIKE pa VIZE**





**UDHËZIM**  
**Nr. 23, datë 7.12.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA  
NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 26.2.2021,  
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE  
MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË  
FONDIT TË PROGRAMIT PËR  
BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN  
RURAL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ligjit nr. 137/2021, “Për buxhetin e vitit 2021”, të pikës 4, të VKM-së nr. 1102, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2021”,

**UDHËZOJMË:**

Në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2021, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun V, pas paragrafit “Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është 15 ditë kalendarike pas publikimit së listës së aplikantëve të kualifikuar, në faqen zyrtare [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al)”, shtohet paragrafi me formulimin:

“Për fondet shtesë të akorduara sipas aktit normativ nr. 34, datë 3.12.2021, afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit është 5 ditë kalendarike pas publikimit të vijës së financimit, të përditësuar sipas listës së aplikantëve të kualifikuar, në faqen zyrtare [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al)”.

2. Në kreun VI, masa 5, nënndarja “iii”, shkronja “a”, zëvendësohet me formulimin: “Dokumentet e certifikimit (certifikatë për statusin e certifikimit dhe anekset e certifikatës ku tregohet kultura e certifikuar) lëshuar nga një trupë kontrolli e miratuar nga MBZHR-ja.

Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t’i dorëzojë pranë Agropikës më të afërt ose zyrës

qendrore të AZHBR-së. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem”.

3. Në kreun VI, masa 6, nënndarja “iii”, shkronjat “c” dhe “e”, zëvendësohen përkatësisht me formulimet:

“c) Faturë tatimore për koston e procesit të implementimit/ose konfirmimit e pagesës së kryer nga aplikanti kur shërbimi i certifikimit është kryer *online*.

e) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Në rastet kur dokumentet e mësipërme aplikanti nuk i disponon në momentin e verifikimit, mund t’i dorëzojë pranë Agropikës më të afërt ose zyrës qendrore të AZHBR-së. Këto dokumente skanohen dhe ngarkohen në sistem”.

4. Në kreun VII, pas pikës 4, shtohen pikat 4.1 dhe 4.2, me formulimet si vijon:

“4.1 Të gjithë aplikantët mbi vijën e financimit, sipas evidencimeve në listën e shpallur në dhjetor 2021, kanë afat deri në 5 ditë kalendarike nga data e përfundimit të aplikimeve, të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në Agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së.

4.2 Përrjashtimisht për masën 1, AZHBR-ja mund të bëjë verifikime në terren për aplikimet, të cilat kanë plotësuar kriteret e përfitueshmërisë, por ndodhen jashtë vijës së financimit dhe që për shkak lëvizjes së vijës së financimit mund të shpallen fitues pas datës së verifikimit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL

**Frida Krifca**

MINISTËR I FINANCAVE DHE  
EKONOMISË

**Delina Ibrahimaj**



**UDHËZIM**  
**Nr. 26, datë 17.12.2021**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 35, DATË 21.9.2020, “PËR KONTROLLIN, REGJISTRIMIN, PËRDORIMIN, RAKORDIMIN, RAPORTIMIN DHE PUBLIKIMIN E FONDEVE TË FINANCIMEVE TË HUAJA NË KUADRIN E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE”**

Në mbështetje të nenit 104, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, në rastet kur, në fazën e aplikimit për përfitimin e fondeve nga projektet e financimit të huaj grant, donatorët kërkojnë një numër llogarie bankare të institucionit përfitues të grantit, ministri përgjegjës për financat e qeverisë,

**UDHËZON:**

1. Pas paragrafit 4.3, të udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, shtohet paragrafi i mëposhtëm:

Në rastet kur, në fazën e aplikimit për përfitimin e fondeve nga projektet e financimit të huaj grant, donatorët kërkojnë një numër llogarie bankare të institucionit kandidat për fitimin e projektit, atëherë të përdoret llogaria e unifikuar e Thesarit “Depozitë e Qeverisë” (TSA) në EUR në Bankën e Shqipërisë:

Emërtimi i llogarisë: “Depozita e Qeverisë në euro”

IBAN: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E

Banka e Përfituesit: Banka e Shqipërisë

Kodi SWIFT/BIC: STANALTRXXX

Adresa e Bankës: Sheshi “Skënderbej”, nr. 1, Tiranë, Albania

Account Holder: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Tiranë, Albania

Adresa: “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë, Albania,

në vend të llogarisë bankare speciale (tranzite), të hapur në Bankën e Shqipërisë në emër të ministrisë përgjegjëse për financat dhe të specifikuar me emërtimin e projektit të financimit të huaj, vetëm për transferimin e mjeteve monetare të kështit të parë të disbursimit të grantit.

Përshkrimi në dokumentin e transfertës së mjeteve monetare nga donatori në TSA të përmbajë emërtimin e saktë të projektit dhe të përfituesit të grantit, pasi mbi bazën e këtij informacioni do të kryhet transfertat në llogarinë operative të përfituesit të grantit në bankën e nivelit të dytë (jashtë TSA-së) për shpenzim dhe kontabilizim në sistemin informatik financiar të qeverisë.

2. Hapja e llogarisë operative të përfituesit të grantit në bankën e nivelit të dytë, kur të përdoret fondi, kryhet detyrimisht mbi bazën e marrëveshjes së nënshkruar nga palët në zbatim të udhëzimit nr. 35 (prot. 17416), datë 21.9.2020, “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

3 Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe njësitë e zbatimit të projekteve me financim të huaj, si dhe strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
Delina Ibrahimaj**



**VENDIM**  
**Nr. 38, datë 2.12.2021**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
 e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare
Elsa Toska	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare
Altin Binaj	anëtar
Përparim Kalo	anëtar
Sonila Bejtja	anëtare
Marsida Xhaferllari	anëtare

me sekretare Belma Lleshi, në datat 23.11.2021  
 dhe 1.12.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare,  
 mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 7 (E) 2021 të  
 Regjistrimit Themeltar, që u përket:

**KËRKUES: EMIN LUSHA**

**SUBJEKT I INTERESUAR:**

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**OBJEKTI:** shfuqizimi i vendimeve nr. 282, datë  
 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor; nr. 36,  
 datë 21.2.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit;  
 nr. 00-2020-991, datë 28.12.2020 të Kolegjit  
 Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të  
 papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së  
 Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49  
 dhe 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
 nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të  
 Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 2 i Protokollit  
 nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për  
 organizimin dhe funksionimin e Gjykatës  
 Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i  
 ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida  
 Xhaferllari, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarit Emin  
 Lusha, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës,  
 prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të  
 Lartë Gjyqësor (*KLJG*), i cili ka kërkuar rrëzimin e  
 kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

**I**  
**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuari Emin Lusha, me vendimin nr. 11,  
 datë 15.5.2019 të Këshillit Drejtues të Shkollës së  
 Magjistraturës, është shpallur kandidat fitues për  
 vitin akademik 2019-2020 në provimin e formimit  
 fillestar, profili gjyqtar.

2. Shkolla e Magjistraturës në datën 27.5.2019 i  
 ka përcjellë KLGJ-së listën e kandidatëve fitues.  
 Kjo e fundit, me vendimin nr. 83, datë 5.6.2019, ka  
 filluar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe  
 figurës për kandidatët fitues, bazuar në ligjin nr.  
 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe  
 prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të  
 ndryshuar (*ligji nr. 96/2016*), gjatë së cilës ka  
 kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet  
 e parashikuara nga ligji për këtë qëllim.

3. Kërkuari është njoftuar nga KLGJ-ja për  
 fillimin e procedurës së verifikimit në datën  
 11.6.2019. Përgjatë kësaj procedure, komunikimi  
 midis KLGJ-së dhe kërkuarit, duke përfshirë edhe  
 dërgimin e akteve dhe të dokumenteve, është  
 zhvilluar në rrugë elektronike.

4. Gjatë procedurës së verifikimit kërkuari ka  
 kundërshtuar në vijimësi përfundimet e  
 Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit  
 të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*ILDKPKI*)  
 për kontrollin e Deklaratës së Pasurisë dhe  
 Interesave Private, të plotësuar prej tij në cilësinë e  
 kandidatit për institucionet e sistemit të drejtësisë.  
 Si rezultat i pretendimeve të vijueshme dhe të  
 dokumentacionit të paraqitur nga kërkuari, KLGJ-  
 ja i ka kërkuar tre herë raportim shtesë ILDKPKI-  
 së.

5. Pas dërgimit të raportit të fundit nga  
 ILDKPKI-ja dhe administrimit të prapësimeve të  
 kërkuarit për këtë raport, relatori e ka parashtruar  
 çështjen e verifikimit të kandidaturës së tij përpara  
 Komisionit të Zhvillimit të Karrierës së KLGJ-së.  
 Ky i fundit në datën 20.11.2019 ka vendosur  
 kalimin e çështjes në mbledhjen plenare të KLGJ-  
 së.

6. Në datën 6.12.2019 kërkuarit i është  
 komunikuar relacioni “Për gjendjen e faktit dhe  
 ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e  
 kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në  
 formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të



kandidatit z. Emin Lusha” i hartuar nga relatori, si dhe është njoftuar se mbledhja plenare e KLGJ-së për shqyrtimin e çështjes së tij do të zhvillohej në datën 10.12.2019.

7. Në mbledhjen plenare të datës 10.12.2019, KLGJ-ja ka marrë vendimin nr. 282 “Për skualifikimin e kandidatit z. Emin Lusha për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2019-2020”, me arsyetimin se ai ka mungesë burimi financiar të ligjshëm për blerjen e pasurive të paluajtshme dhe se është vërtetuar deklarim jo i saktë i pasurisë, ndërsa *konkluzionet e tjera të përshkruara në raportet e ILDKPKI-së i ka vlerësuar të pabazuara.*

8. Kërkuesi e ka kundërshtuar vendimin e skualifikimit në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila, me vendimin nr. 36, datë 21.2.2020, ka vendosur: **“Rrëzimin e kërkesëpadisë.”. Në vijim, i vënë në lëvizje me rekurs të kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-991, datë 28.12.2020, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se shkaqet e ngritura në rekurs kanë marrë përgjigje në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit dhe se nuk përmban shkaqe ligjore.**

9. Në datën 2.6.2021 kërkuesi i është drejtuar me ankim kushtetues individual Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve të KLGJ-së, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Me vendimin e datës 28.7.2021, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 22.9.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

## II

### Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. **Kërkuesi Emin Lusha**, në ankimin drejtuar Gjykatës, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar këto të drejta kushtetuese:

10.1 *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

10.1.1 *Të drejtën për shqyrtim efektiv*, pasi KLGJ-ja nuk ka hetuar në mënyrë të pavarur, por ka marrë të mirëqenë vlerësimin e pasurisë të kryer nga

ILDKPKI-ja. Të metat e hetimit administrativ të kryer nga KLGJ-ja nuk janë riparuar nga gjykata e apelit, e cila, edhe pse e ka pranuar si provë aktin e ekspertimit kontabël të paraqitur nga kërkuesi, nuk ka shprehur qëndrim për konkluzionet e ekspertit. Gjykata e Lartë nuk e ka konsideruar shkelje këtë qëndrim të gjykatës së apelit.

10.1.2 *Të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe parimin e barazisë së armëve e kontradiktoritetit*, pasi KLGJ-ja i ka njoftuar kërkuesit gjetjet e ILDKPKI-së, por jo gjetjet e saj, që çuan në skualifikimin e tij. KLGJ-ja nuk e ka thirrur kërkuesin për ta dëgjuar, pra nuk i ka dhënë mundësi të mbrohej efektivisht. Këto të drejta janë shkelur edhe nga gjykata e apelit, e cila nuk e ka vlerësuar aktin e ekspertimit të paraqitur nga kërkuesi.

10.1.3 *Standardin e arsyesimit të vendimit*, pasi vendimi i KLGJ-së është alogjik, kontradiktor dhe arbitrar. Kërkuesi është detyruar të paraqesë dokumentacion justifikues për të ardhurat dhe shpenzimet, të cilin nuk kishte mundësi objektive ta siguronte. Ai është detyruar të mbledhë dokumentacion financiar dhe kontabël nga subjekte të ndryshme, të cilët nuk kanë pasur detyrim për ruajtjen e këtij dokumentacioni për një kohë kaq të gjatë. Standardi i përdorur për kërkuesin ka qenë më pak i favorshëm se ai i përdorur nga organet e rivlerësimit kalimtar. Standardi i arsyesimit nuk është respektuar as nga gjykatat, pasi gjykata e apelit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim dhe as provës thelbësore, që ishte akti i ekspertimit i paraqitur nga kërkuesi, kurse Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të paraqitura në rekurs.

10.1.4 *Parimin e paanshmërisë*, pasi KLGJ-ja i ka dhënë vlerë të paracaktuar raportit të ILDKPKI-së, duke mos konsideruar tërësinë e provave dhe pretendimeve të kërkuesit. Ajo e ka paragjykuar çështjen, pasi ka parashtruar në vendim faktet e ILDKPKI-së për verifikimin e pasurive të të atit të kërkuesit gjatë rivlerësimit kalimtar të tij në detyrën e gjyqtarit, edhe pse ky i fundit ende nuk i ishte nënshtruar hetimit administrativ të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe nuk ishte njoftuar për raportin e ILDKPKI-së. Gjykatat kanë qenë të njëanshme në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuesit, pasi kanë kryer vlerësime në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.



10.1.5 *Parimin e sigurisë juridike dhe të pritsmërive të ligjshme*, pasi në raste të tjera të ngjashme KLGJ-ja nuk i ka dhënë efekt penalizues pasaktësive në deklaratat vjetore të pasurive të bëra nga vetë kandidati dhe jo më, si në rastin konkret, të atyre që janë të të atit të kërkuarit. Bashkëshortja e kërkuarit dhe prindërit e saj nuk kanë qenë më parë deklarues të pasurive dhe nuk kanë pasur detyrim për ruajtjen e dokumentacionit. ILDKPKI-ja i ka konsideruar këta të fundit persona të lidhur dhe ka verifikuar pasuritë e tyre, pa u kërkuar autorizim për këtë qëllim. KLGJ-ja dhe gjykata e apelit kanë aplikuar standarde të dyfishta. Ato nuk kanë marrë në konsideratë informalitetin në Shqipëri, që është pranuar edhe nga Komisioni i Venecias. Pavarësisht parimit të përgjegjësive individuale, kërkuari është bërë përgjegjës për deklaratimet e të atit, edhe pse ndaj tij në atë kohë ende nuk kishte një vendim nga KPK-ja. Po ashtu, janë cenuar pritsmëritë e ligjshme të kërkuarit për të qenë i pranishëm në çdo procedim që zhvillohet për të drejtat subjektive ose interesat e tij të ligjshëm dhe për të realizuar një mbrojtje efektive.

10.2 *Të drejtën për arsim*, të garantuar nga neni 57 i Kushtetutës, pasi kërkuari nuk mund të parashikonte kriteret që u aplikuan për vlerësimin e kandidaturës së tij për ndjekjen e programit të trajnimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për shkak se KLGJ-ja dhe gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor në fuqi.

10.3 *Të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë*, të garantuar nga neni 49, pika 1, i Kushtetutës, pasi kërkuari është skualifikuar bazuar në kriteret/kushte që nuk parashikohen nga kuadri ligjor në fuqi.

10.4 *Të drejtën e jetës private*, të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, pasi, si rezultat i vendimeve të kundërshtuara, kërkuari iu bë i pamundur ushtrimi i profesionit të gjyqtarit, për rrjedhojë atij iu prek dinjiteti, personaliteti dhe zhvillimi i marrëdhënieve me botën e jashtme.

11. **Subjekti i interesuar, KLGJ-ja**, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuarit si vijon:

11.1 Pretendimi se KLGJ-ja nuk ka kryer *betim efektiv* është i pabazuar, pasi ky organ ka vepruar në bazë të nenit 32, pika 4, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016, që për skualifikimin e kandidatit i referohet raportit të ILDKPKI-së. Ashtu siç ka

konstatuar edhe gjykata e apelit, KLGJ-ja nuk e ka marrë të mirëqenë këtë raport.

11.2 Kërkuarit i është respektuar *e drejta për t’u dëgjuar* në procedurën administrative, pasi ai ka dhënë shpjegime rreth gjetjeve dhe ka paraqitur dokumente për pretendimet e tij.

11.3 *Vendimi i KLGJ-së është i arsyetuar*, pasi argumenton në mënyrë shteruese gjetjet, pretendimet e kërkuarit, situatën faktike dhe kuadrin ligjor mbi të cilin është bazuar. Gjykata e apelit, gjithashtu, u ka dhënë përgjigje të hollësishme të gjitha pretendimeve të kërkuarit, kurse Gjykata e Lartë, pasi ka konstatuar se shkaqet e rekursit kishin marrë përgjigje në vendimin e gjykatës së apelit, ka vendosur mospranimin e tij. Çaktimi i ekspertit dhe kryerja e ekspertizës nuk do të zëvendësonte raportin e ILDKPKI-së. Për më tepër, eksperti nuk mund të përgjigjej për pretendimet me natyrë ligjore dhe as të jepte ndonjë “mendim teknik” për mungesën e dokumentacionit të kërkuarit që justifikonte pasurinë e tij.

11.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi kërkuari i ishte referuar vetë deklaratave të depozituara nga i ati dhe, sipas ligjit, ILDKPKI-ja ishte e detyruar t’i referohej raportit për verifikimin e pasurisë së këtij të fundit që konsiderohet person i lidhur me kërkuarin. Vendimmarrja e KLGJ-së është objektive dhe proporcionale. Kërkuari nuk ka përcaktuar se me cilin rast të KPK-së e krahason çështjen e tij. KLGJ-ja ka vendosur ndryshe në raste të tjera për arsye se kandidatët e tjerë kanë qenë në kushte të ndryshme.

11.5 Kërkuarit nuk i janë cenuar *pritsmëritë e ligjshme*, pasi ai ka qenë në dijeni se para fillimit të Shkollës së Magjistraturës do t’i nënshtrohej procesit të verifikimit të pasurisë, i cili përfshin edhe hetimin e pasurisë së personave të lidhur. Pritshmëritë legjitime nuk lidhen me humbjet potenciale në të ardhmen, siç pretendon kërkuari.

11.6 Pretendimet për cenimin e *së drejtës për arsim*, për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë dhe të jetës private janë të pabazuara, pasi veprimtaria e KLGJ-së dhe e gjykatave ka qenë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Kërkuari është skualifikuar për shkak të moskalimit me sukses të procesit të verifikimit të pasurisë së tij.





## III

## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

## A. Për legjitimitimin e kërkesit

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

13. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë në mënyrë kumulative kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Gjykata vëren se kërkuksi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin ligjor të përfunduar me vendimet që ai kundërshton në këtë Gjykatë dhe, si i tillë, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një tjetër kriter paraprak i ankimit kushtetues individual lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuksi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës; ose ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.

16. Për të përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve, kërkuksi duhet të vërtetojë se para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura, jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjete juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti

i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton se kërkuksi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike “efektive”, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv” (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 31, datë 4.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në analizë të përmbushjes së këtij kriteri, Gjykata vëren se pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual janë parashtruar nga kërkuksi në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë edhe pse disa prej tyre, siç janë ato për cenimin e parimit të sigurisë juridike për mënyrën e vlerësimit të pasurive të bashkëshortes dhe familjes së saj, si dhe të dhuratave të dasmës së tij, nuk janë analizuar hollësisht në drejtim të shkeljes konkrete të së drejtës dhe të shkakut kushtetues/ligjor. Pavarësisht kësaj, për sa kohë që në rekurs kërkuksi i ka parashtruar të gjitha pretendimet në substancë, Gjykata e vlerëson të plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 28.12.2020, por sipas shkresës së kancelarit të asaj gjykate, ai “...është dorëzuar në sekretari i firmosur nga trupa gjyqësore në datën 3.2.2021, datë në të cilën ky vendim ka qenë i disponueshëm për t'u tërhequr nga palët ndërgjyqësë”. Në kushtet kur në ankimin kushtetues ngrihen pretendime që, sipas kërkesit, duhej të ishin shqyrtuar dhe të kishin marrë përgjigje në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese konsiderohet data 3.2.2021, në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë efektivisht i disponueshëm për kërkuksin dhe ai është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate. Gjykata konstaton se ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 2.6.2021, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*.



19. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata konstaton se kërkuksi ka parashtruar në kërkesë dy grupe pretendimesh. Grupi i parë ka natyrë procedurale dhe lidhet me cenimin e së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, në disa aspekte të saj. Ndërsa grupi i dytë përfshin pretendime me natyrë materiale, që lidhen me cenimin e të drejtave për arsim dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë, si dhe asaj për jetë private, të parashikuara respektivisht nga nenet 57, 49 dhe 35 të Kushtetutës.

20. Në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, kërkuksi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, për shkak se KLGJ-ja i ka dhënë vlerë të paracaktuar raportit të ILDKPKI-së, duke mos marrë në konsideratë provat dhe pretendimet e tij. Sipas tij, parashtrimi në vendimin e KLGJ-së i fakteve për të atin e tij e ka paragjykuar çështjen. Gjykata vëren se në lidhje me paanshmërinë objektive nuk rezulton ndonjë e dhënë që do ta vinte në dyshim respektimin e këtij parimi, *ndërkohë që* pretendimet e tij kërkuksi i ka lidhur, *në thelb*, me mënyrën se si KLGJ-ja e ka vlerësuar çështjen e tij. Edhe për sa i përket paanshmërisë personale (subjektive), kërkuksi nuk ka paraqitur ndonjë provë për ta mbështetur atë. Po ashtu, edhe pretendimet për cenimin e parimit të sigurisë juridike në drejtim të mosmarrjes parasysh të informalitetit dhe të aplikimit të standardeve të dyfishta, si dhe të mënyrës së si është zbatuar ligji në çështje të tjera nga vetë KLGJ-ja apo organet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në thelb, kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes së kërkuksit nga KLGJ-ja dhe gjykatat. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuksi nuk ka arritur t'i ngrëjë këto pretendime në nivel kushtetues dhe, si të tilla, ato nuk mund të merren në shqyrtim.

21. Në lidhje me të drejtat për arsim dhe për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme të zgjedhur vetë, kërkuksi ka pretenduar se KLGJ-ja dhe gjykatat kanë vepruar në mënyrë të tillë, që i kanë hequr mundësinë të parashikonte kriteret e zbatuara për verifikimin e kandidaturës së tij. Sipas kërkuksit, pavarësisht se ai ishte në dijeni të kuadrit juridik në fuqi në kohën e konkurrimit, praktikisht është përballur me veprime të organeve publike, të cilat e kanë skualifikuar bazuar në kriteret/kushte të

parashikuara. Gjykata vlerëson se edhe këto pretendime nuk janë ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim, pasi kërkuksi nuk ka argumentuar përse kualifikimi i tij si kandidat gjyqtar për vazhdimin e trajnimit në Shkollën e Magistraturës përfshihet në fushën e veprimit të këtyre të drejtave kushtetuese.

22. Po në kuptim të legjitimitet *ratione materiae*, pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuksi janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, prandaj Gjykata në vijim do të shqyrtojë bazueshmërinë e tyre në themel.

#### B. Për themelin e pretendimeve

##### B.1. Për të drejtën për proces të rregullt ligjor

23. Sipas kërkuksit, gjatë procedurës administrative dhe asaj gjyqësore për shqyrtimin e çështjes së tij është cenuar e drejta e procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për hetim efektiv, asaj për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike.

24. Gjykata vëren se edhe pse kërkuksi i ka ngritur këto pretendime të ndara nga njëra-tjetra, ato, në thelb, bazohen mbi të njëjtat fakte, që sipas tij kanë cenuar të drejtat dhe parimet kushtetuese gjatë procedurës administrative, të cilat nuk janë riparuar gjatë procesit gjyqësor.

25. Për rrjedhojë, nga pikëpamja e të drejtave kushtetuese, Gjykata vlerëson t'i analizojë së bashku të gjitha elementet e së drejtës për proces të rregullt ligjor, që sipas kërkuksit janë shkëlur nga organi administrativ dhe gjykatat, duke e vlerësuar procesin në tërësinë e tij. Ndërsa nga pikëpamja e procesit që pretendohet të ketë cenuar këto të drejta, Gjykata vlerëson të analizojë fillimisht respektimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe elementet e saj gjatë procedurës administrative të zhvilluar nga ana e KLGJ-së dhe, më pas, edhe gjatë gjykimit të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë.

26. Në këtë vlerësim, Gjykata mban parasysh standardet e jurisprudencës kushtetuese, sipas së cilës kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë*



16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata thekson se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar.

#### B.1.1. Për procesin administrativ

27. Kërkuesi pretendon se KLGJ-ja nuk ka respektuar të drejtën e tij për t'u dëgjuar dhe atë për mbrojtje efektive, si dhe parimin e barazisë së armëve e të kontradiktoritetit, pasi nuk e ka njoftuar për gjetjet që çuan në skualifikimin e tij dhe nuk e ka thirrur për t'u dëgjuar. KLGJ-ja ka marrë të mirëqenë vlerësimin e pasurisë të kryer nga ILDKPKI-ja dhe nuk ka hetuar në mënyrë të pavarur, për rrjedhojë nuk ka argumentuar se përse nuk qëndronin pretendimet e tij.

28. Në lidhje me standardin e arsytimit, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i KLGJ-së është tërësisht alogjik dhe arbitrar, pasi ai është detyruar në mënyrë të tepruar për të mbledhur dokumentacion financiar dhe kontabël nga subjekte të ndryshme, të cilat nuk kanë detyrim për ruajtjen e tyre për një kohë kaq të gjatë. KLGJ-ja i ka vendosur kërkuesit një detyrim të pamundur objektivist për t'u përmbushur, pasi i ka kërkuar të paraqiste dokumentacion justifikues për të ardhurat dhe shpenzimet e martesës, si dhe për pasuritë paramartesore të bashkëshortes dhe prindërve të saj. Në këtë drejtim, standardi i përdorur për kërkuesin është më pak i favorshëm se ai i përdorur nga organet e rivlerësimit kalimtar.

29. Pretendimet për detyrimin e tepruar për paraqitjen e dokumentacionit justifikues kërkuesi i ka ngritur edhe në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike. Po në lidhje me këtë parim, kërkuesi ka pretenduar se KLGJ-ja nuk ka zbatuar vendime gjyqësore të formës së prerë për raste të tjera, sipas të cilave ky organ është i detyruar të kryejë hetime të thelluara, duke mos marrë të mirëqena raportet e ILDKPKI-së. KLGJ-ja, gjithashtu, e ka përballur kërkuesin me përgjegjësi për deklarime të kryera nga i ati, edhe pse ndaj këtij të fundit nuk kishte ende një vendim nga KPK-ja.

30. Sipas subjektit të interesuar, KLGJ-së, procesi administrativ për verifikimin e kandidaturës së kërkuesit ka qenë i rregullt në aspektet e të drejtave për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, si dhe të parimit të kontradiktoritetit. Kërkuesi është njoftuar për çdo raport të ILDKPKI-së, si dhe i është respektuar e drejta për të dhënë shpjegime për gjetjet dhe për të paraqitur prova. KLGJ-ja e ka bërë analizën e saj bazuar në raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, dokumentacionin e paraqitur nga vetë kërkuesi dhe korrespondencën me subjekte shtetërore dhe private. Në përfundim, KLGJ-ja i ka konsideruar të sakta disa nga konstatimet e ILDKPKI-së dhe të pabazuara pretendimet e kërkuesit lidhur me to, ndërkohë që ka vendosur të mos konsiderojë konstatimet e tjera të atij organi.

31. Gjithashtu, subjekti i interesuar ka prapësuar se vendimi i KLGJ-së ka respektuar standardin e arsytimit, pasi nuk ka kundërshti ose mungesë logjike. Ai përmban argumente të hollësishme për gjetjet, situatën faktike, pretendimet e kërkuesit, si dhe kuadrin ligjor mbi bazën e të cilit është marrë. Analiza financiare është e hollësishme dhe e saktë.

32. Sipas subjektit të interesuar nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi kërkuesi ka pasur dijeni se para fillimit të Shkollës së Magjistraturës do t'i nënshtrohej edhe procesit të verifikimit të pasurisë, i cili përfshin edhe hetimin e pasurisë së personave të lidhur. Po ashtu, nuk janë cenuar as pritshmëritë e ligjshme të kërkuesit, pasi ai nuk ka pësuar anulim, ndryshim përkeqësues ose humbje konkrete dhe të menjëhershme të të drejtave të tij, në kushtet kur nuk i kishte fituar ende ato.

33. Gjykata vëren se neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ato ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

34. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit me faktet



që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohej edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimet nr. 25, datë 10.5.2021; nr. 29, datë 27.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në lidhje me standardin e arsytimit të aktit administrativ në kuadër të procesit të rregullt ligjor, Gjykata ka pohuar se Kodi i Procedurave Administrative (KPA) ka përcaktuar elementet që duhet të përmbajë akti administrativ i shkruar. Përveç elementeve formale, akti administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përmbajë, krahas shpjegimit të situatës faktike mbi të cilën është marrë, edhe shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave, bazën ligjore të aktit, një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast, si dhe në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar (*shih vendimet nr. 25, datë 10.5.2021; nr. 29, datë 27.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata thekson se parametrat kushtetuese që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, duhet të përmbushen nga organet e administratës publike nëpërmjet zbatimit të dispozitave ligjore, konkretisht të KPA-së. Në këtë këndvështrim, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar organet e pushtetit publik, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi administrativ ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe, në vijim, nëse gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar veprimet dhe vendimmarrjen e organit administrativ, kanë vepruar në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, siç është pohuar në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve

kushtetuese është në radhë të parë funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 13, datë 9.3.2021; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 83, datë 26.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Duke iu referuar rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vëren se në procesin administrativ të zhvilluar nga KLGJ-ja kërkuesi e ka realizuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur *nëpërmjet komunikimit të dokumenteve, raporteve dhe akteve të nxjerra nga organet e përfshira në këtë proces. Atij i është dhënë mundësia disa herë të paraqesë shpjegime me shkrim dhe të deponojë dokumente në lidhje me rezultatet e hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja. Pikërisht, bazuar në pretendimet dhe dokumentet e paraqitura nga vetë kërkuesi, KLGJ-ja i ka kërkuar raporte shtesë ILDKPKI-së, derisa procedura e verifikimit është plotësuar. Po ashtu, siç pranon edhe vetë kërkuesi, ai është njoftuar për datën e zhvillimit të mbledhjes plenare të KLGJ-së dhe i është komunikuar edhe relacioni i relatorit. Ky akt i fundit, në thelb, paraqet në mënyrë të përmbledhur procedurën dhe gjendjen e faktit e të ligjit, me qëllim që anëtarët e KLGJ-së të vendosin në lidhje me çështjen objektivisht.*

38. Për sa më lart, Gjykata konstaton se KLGJ-ja ka respektuar të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, sepse ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në nenet 87-89 të KPA-së, sipas së cilës kjo e drejtë ushtrohet në çdo formë të përshtatshme, duke përfshirë paraqitjen e mendimeve, komenteve dhe shpjegimeve për vlerësimin e provave të administruara, rezultatet e hetimit dhe rezultatit e mundshëm të procedurës. E drejta për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, *nuk nënkupton vetëm atë për t'u paraqitur personalisht para organit administrativ, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra mbi komentet dhe shpjegimet e dhëna me shkrim gjatë kësaj procedure. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesit nuk i është cenuar nga KLGJ-ja e drejta për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur efektivisht.*

39. Për sa i takon arsytimit të vendimit të KLGJ-së, Gjykata konstaton se ai përmban të dhëna për procedurën e zhvilluar, rezultatet e verifikimit për kriteret e pranimit në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës dhe provat ku ato bazohen, prapësimet e kandidatit në lidhje me gjetjet e ILDKPKI-së për kriterin e pasurisë, ligjin e zbatueshëm, si dhe analizën ligjore të gjetjeve,



duke shpjeguar kriterin ligjor që nuk plotësohet nga kandidatura e kërkuesit. Në vlerësimin e Gjykatës, ky vendim respekton edhe standardin e arsytimit të aktit administrativ, pasi është i qartë dhe nuk rezulton të jetë alogjik ose të ketë kundërthënie.

40. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se vendimi i KLGJ-së është tërësisht alogjik dhe arbitrar, pasi detyrimi që atij i është caktuar nga ky organ për të paraqitur dokumentacion ka qenë i tepruar dhe i pamundur objektivisht. Pretendimet për detyrimin e tepruar për paraqitjen e dokumentacionit justifikues kërkuesi i ka ngritur edhe në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike. Sipas tij, pavarësisht parimit të përgjegjësisë individuale, ai është përballur me përgjegjësi për deklaratimet e të atit, për të cilin në atë kohë ende nuk kishte një vendim nga KPK-ja dhe se standardi i përdorur për kërkuesin është më pak i favorshëm se ai i përdorur nga organet e rivlerësimit kalimtar.

41. Gjykata vlerëson se, pavarësisht se si janë parashtruar këto pretendime, ato do të trajtohen në vijim në këndvështrim të procesit të rregullt në aspektin e së drejtës së mbrojtjes efektive. Gjykata do të kontrollojë nëse procedura e zhvilluar nga KLGJ-ja për verifikimin e kandidaturës së kërkuesit ka qenë e drejtë dhe jo arbitrare, pra nëse ai është vendosur në një pozitë të vështirë për të gjetur dokumentacion mbështetës, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes, që sipas kërkuesit ka të bëjë me vendosjen e një barrë të tepruar prove.

42. Procesi i verifikimit të kandidatëve për gjyqtarë parashikohet në nenin 136/a të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtarë mund të jenë shtetasit shqiptarë që emërohen nga KLGJ-ja pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe pas kryerjes së procesit të verifikimit paraprak të pasurisë dhe të figurës së tyre, sipas ligjit.

43. Gjykata evidenton fillimisht se procesi i verifikimit të kandidatit për gjyqtar, në kuptim të nenit 136/a të Kushtetutës, si regjim i përhershëm është i ndryshëm nga procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarit në detyrë, në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe Aneksit të saj, si regjim tranzitor. Në këto dy procese zbatohen parime dhe standarde të ndryshme, pasi tek i pari është kandidati për gjyqtar që e vë atë në lëvizje dhe në rast se procesi është i suksesshëm, ai fiton të drejtën e emërimit; ndërsa procesi i rivlerësimit kalimtar jo vetëm nuk vihet në lëvizje nga subjekti, por në përfundim të tij

ai mund të humbasë të drejta të fituara. Ashtu siç ka pohuar Gjykata në jurisprudencën e saj, procesi i rivlerësimit kalimtar është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, e ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, zbatimi i së cilës kufizon pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës, si dhe neneve A dhe Ç të Aneksit të saj, një sërë të drejtash kushtetuese të gjyqtarit në detyrë, duke përfshirë edhe dispozitat që lidhen me barrën e provës (*shih vendimin nr. 2, datë 18.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Sipas kësaj analize, Gjykata vëren se në ndryshim nga procesi i verifikimit të kandidatit për gjyqtar, në procesin e rivlerësimit kalimtar Aneksi i Kushtetutës ka përcaktuar rregulla të shprehura për barrën e provës, sipas të cilave, me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, dispozitat që lidhen me barrën e provës kufizohen pjesërisht (neni A, pika 1) dhe ajo i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal (neni Ç, pika 5). Për këtë kalim të barrës së provës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) ka theksuar se ai nuk është *per se* arbitrar për qëllimet e procesit të rregullt, të garantuar nga neni 6, pika 1, i KEDNJ-së, në kushtet kur subjektit të rivlerësimit i janë vënë në dispozicion gjetjet paraprake që kanë rezultuar nga përfundimi i hetimit dhe i është dhënë akses në provat e çështjes (*shih Xboxhaj k. Shqipërisë, 9 shkurt 2021, §352*).

45. Ndërsa *procedura administrative që zhvillon KLGJ-ja për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatët për magjistratë*, vihet në lëvizje me kërkesë të kandidatit që aplikon, pas thirrjes së publikuar nga organi publik. Për rrjedhojë, në këto raste, barra e provës i përket kandidatit që e vë organin publik në lëvizje për të nxjerrë aktin administrativ (neni 82 i KPA-së). Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se ligji nr. 96/2016, i miratuar bazuar në nenin 136/a të Kushtetutës për të përcaktuar procedurën e verifikimit të kandidatëve magjistratë, parashikon shprehimisht se KLGJ-ja, gjatë procesit të verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës së kandidatit, ndihmohet edhe nga ILDKPKI-ja si organi kompetent për verifikimin e pasurisë dhe që, në kuptim të dispozitave të këtij ligji, përgatit raportin përkatës, si dhe paraqet çdo informacion, dokumentacion ose materiale të tjera në lidhje me këtë hetim, të kërkuara nga Këshilli (neni 32).



46. Në kushtet kur Kushtetuta, në ndryshim nga procesi i rivlerësimit kalimtar, në procesin e verifikimit të kandidatit për gjyqtar nuk ka përcaktuar kufizim të barrës së provës, kjo e fundit nuk përbën standard kushtetues të këtij procesi dhe as nuk mund të trajtohet si aspekt i parimit të sigurisë juridike, për sa kohë që me anë të këtij procesi nuk vihen në rrezik të drejta të fituara. Megjithatë, në rastin konkret, nisur nga argumentet e kërkuarit, Gjykata vlerëson se duhet ta trajtojë këtë pretendim në drejtim të së drejtës së mbrojtjes, në kuadër të procesit të rregullt, më konkretisht duke kontrolluar nëse kërkuari është vendosur në një pozitë të tillë gjatë procedurës së verifikimit të pasurisë së tij nga KLGJ-ja, që ia ka bërë të pamundur realizimin e kësaj të drejte në substancë.

47. Gjykata vëren se KLGJ-ja e ka shqyrtuar çështjen e kërkuarit dhe ka nxjerrë përfundimet e saj duke analizuar rrethanat konkrete, aktet e organeve ndihmëse në këtë proces sipas ligjit, përfshi raportet e ILDKPKI-së, si dhe pretendimet dhe provat e paraqitura nga kërkuari. Gjetjet e ILDKPKI-së dhe kundërshtimet e kërkuarit janë analizuar në mënyrë të plotë, madje disa prej gjetjeve janë vlerësuar si të pabazuara (*shih paragrafët 26 dhe 27 të vendimit të KLGJ-së*).

48. Po ashtu, Gjykata konstaton se ILDKPKI-ja ka verifikuar pasuritë e kërkuarit dhe të personave të lidhur me të, bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Lidhur me të atin e kërkuarit, nuk rezulton që veprimet e tij të jenë bërë shkas për skualifikim, ndërkohë që, siç rezulton edhe nga përmbajtja e vendimit të kundërshtuar të KLGJ-së, deklaratimet e tij janë përdorur për të verifikuar saktësinë e të dhënave të deklaruara nga vetë kërkuari, për shkak të referencave që ky i fundit ka bërë në to.

49. *Për sa më sipër, Gjykata çmon se*, në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, ai nuk është vendosur në pozitë objektivist të pamundur për të realizuar të drejtën e mbrojtjes në procesin administrativ të verifikimit të kandidaturës së tij. Në këtë proces, i cili vihet në lëvizje prej vetë kandidatit, detyrimi për të provuar faktet për pasurinë e tij i takon pikërisht këtij të fundit. Po ashtu, ILDKPKI-ja dhe KLGJ-ja kanë vepruar në përputhje me regjimin e dispozitave të këtij procesi, si dhe duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor. KLGJ-ja i ka

komunikuar kërkuarit çdo akt të paraqitur nga ILDKPKI-ja lidhur me vlerësimin e pasurisë, duke i dhënë kohën e mjaftueshme për të paraqitur prapësime dhe prova. Ai ka paraqitur në kundërshtim të gjetjeve të ILDKPKI-së argumente të zgjeruara me shkrim, si dhe çdo dokument që e ka vlerësuar të nevojshëm, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga KLGJ-ja. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuarit nuk i është cenuar e drejta e mbrojtjes efektive gjatë procesit administrativ.

50. Si përfundim, duke i përmbledhur të gjitha argumentet e mësipërme, Gjykata e vlerëson të pabazuar pretendimin e kërkuarit se KLGJ-ja i ka cenuar të drejtën kushtetuese për proces të rregullt ligjor, për shkaqet e parashtruara prej tij.

#### *B.1.2. Për procesin gjyqësor*

51. *Kërkuari ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt në disa aspekte. Sipas tij, gjykatat kanë cenuar standardin e arsytimit, pasi vendimet gjyqësore rendisin vetëm rrethanat e faktit, pa i interpretuar ato në raport me ligjin dhe pa i dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të kërkuarit, përfshi aktin e ekspertimit privat. Po ashtu, sipas tij, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve, akti i ekspertimit i përpiluar nga eksperti i licencuar dhe i paraqitur prej kërkuarit në gjykim nuk është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit. Ky qëndrim nuk është konsideruar shkelje dhe nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë.*

52. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar pretendimin e kërkuarit për procesin e rregullt ligjor, duke parashtruar se procedura e verifikimit të kandidaturës së tij nuk ka pasur shkelje. Sipas KLGJ-së, gjykatat kanë respektuar edhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjykata e apelit i ka dhënë përgjigje të detajuar të gjitha pretendimeve të kërkuarit, kurse Gjykata e Lartë, pasi ka vlerësuar shkaqet e rekursit dhe ka konstatuar se pretendimet e kërkuarit kanë marrë përgjigje nga vendimi i gjykatës së apelit, ka vendosur mospranimin e tij.

53. Gjykata e ka vlerësuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor si një detyrim të sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës dhe një garanci për procesin e rregullt ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato



janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Megjithatë, zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetim (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Për sa i takon parimit të barazisë së armëve, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se sipas tij, çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e saj. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është formale, ku palëve iu garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit gjyqësor, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e palës tjetër, e bën të cenueshëm procesin gjyqësor. E drejta për proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe të drejtën e të dyja palëve në proces për të pasur informacion për argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë gjyqësore të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra. Në këtë mënyrë gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar, gjithashtu, dallimi që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të

tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj. Po ashtu, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata e zakonshme mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 1.4.2021; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 19, datë 19.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

57. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Detyra e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë (*shih vendimet nr. 26, datë 9.5.2014; nr. 40, datë 22.9.2011; nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata rithekson se në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, ajo vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimin nr. 7, datë 28.2.2000 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Në të njëjtën linjë, Protokollin nr. 14 i KEDNJ-së ka shtuar një kriter të ri për vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesave për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore, i cili mbështetet në parimin *de minimis non curat praetor*. Në thelb ky



parim kërkon që autoriteti që vlerëson pretendimet për këto shkelje nuk duhet të merret me çështje të vogla të papërfillshme. Ky kriter i ri është interpretuar nga GJEDNJ-ja si një filtër për mospranimin e kërkesave kur kërkuesi nuk ka pësuar ndonjë dëm të rëndësishëm, përveç rasteve kur respektimi i këtyre të drejtave kërkon një shqyrtim të ankimit për sa i përket thelbit (*shih Burov k. Moldavisë, nr. 38875/03, 14 qershor 2011; Stefanescu k. Rumanisë, nr. 11774/04, 12 prill 2011; Rinck k. Francës, nr. 18774/09, 19 tetor 2010*).

59. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka pobuar se neni 6 i KEDNJ-së, që garanton të drejtën për proces të rregullt, nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave ose mënyrën se si duhet të vlerësohen ato, të cilat janë çështje që rregullohen nga ligji i brendshëm dhe vlerësohen nga gjykatat vendase. U takon këtyre gjykatave të vlerësojnë rëndësinë e provave të paraqitura, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (*shih Lady S.R.L. k. Republika e Moldavisë, 23 tetor 2018, §27; Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë [DHM], 7 qershor 2012, §198*). Detyrë e GJEDNJ-së është të vlerësojë nëse procedurat në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta dhe për këtë qëllim ajo vlerëson nëse provat janë paraqitur në një mënyrë të tillë që ka garantuar një proces të drejtë dhe nëse vendimet procedurale kanë qenë të drejta (*shih Devinar k. Sllovenisë, 22 maj 2018, §45; Blücher k. Republikës Çeke, 11 janar 2005, §65; Tamminen k. Finlandës, 15 qershor 2004, §34*).

60. Qëndrimet tepër formale dhe strikte nga gjykatat vendase nuk mbështeten nga GJEDNJ-ja, e cila ka theksuar detyrimin që kanë këto gjykata për të interpretuar kërkesat procedurale në mënyrë proporcionale dhe të arsyeshme (*shih Stone Court Shipping Company, S.A. k. Spanjës, 28 tetor 2003, §§33-35; Miragall Escolano dhe të tjerë k. Spanjës, 25 janar 2000, §§36-38; Pérez de Rada Cavanilles k. Spanjës, 28 tetor 1998, §45*).

61. Megjithatë, rregullat për pranueshmërinë e provave ndonjëherë mund të bien ndesh me parimet e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, ose përndryshe të ndikojnë në drejtësinë e procedurave (*shih Khodorkovskiy dhe Lebedev k. Rusisë, datë 25 korrik 2013, §728*). Duke mbajtur në konsideratë ngjashmërinë e procedurave administrative që kanë natyrë sanksionatore, me procesin penal, Gjykata eidenton se GJEDNJ-ja ka pohuar se megjithëse “neni 6 nuk shkon aq larg sa të kërkojë që mbrojtjes t’i

jepen të njëjtat të drejta si prokuroria në marrjen e provave”, i akuzuari duhet të ketë të drejtë të kërkojë dhe të japë prova “në të njëjtat kushte” si prokuroria (*shih Dombó Bebeer BV k. Holandës, 27 tetor 1993, §33*).

62. Për sa i përket rolit të ekspertit në gjykim, sipas GJEDNJ-së mënyra se si ai i ka ushtruar detyrat dhe mënyra se si gjyqtari e ka vlerësuar opinionin e tij, janë faktorë me rëndësi që duhen marrë parasysh në vlerësimin nëse është respektuar parimi i barazisë së armëve (*shih Devinar k. Sllovenisë, 22 maj 2018, §47*).

63. Nisur nga standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuësin dhe për interesat që ai përfaqëson.

64. Duke iu kthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata, referuar rrethanave të saj, vëren se kërkuësi i ka bashkëngjitur kërkesëpadisë edhe një aktekspertimi të hartuar prej një eksperti kontabël të licencuar. Në seancën gjyqësore të datës 12.2.2020, Gjykata Administrative e Apelit, pasi ka deklaruar të hapur hetimin gjyqësor, i ka dhënë fjalën kërkuësit, në cilësinë e palës paditëse, i cili ka relatuar parashtrimet me shkrim dhe ka vënë në dispozicion të gjykatës dhe palës së paditur një kopje të tyre. Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë vendim të ndërmjetëm për të lejuar ose refuzuar marrjen e provave të paraqitura nga kërkuësi, por ka evidentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore se bashkëlidhur kërkesëpadisë është depozituar, si akt provues, akti i ekspertimit kontabël i ekspertes A.B. dhe ka pyetur kërkuësin nëse ka akte të tjera provuese për të depozituar. Kërkuësi ka cituar aktet që ka vënë në dispozicion të gjykatës. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit ka dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit të interesuar KLGJ-së, në cilësinë e të paditurit në atë gjykim, dhe ka marrë vendim të ndërmjetëm për administrimin e akteve të depozituara prej tij, bashkëlidhur prapësimeve. Nuk rezulton që kërkuësi, përgjatë gjithë procesit gjyqësor, të ketë kërkuar me shkrim ose me gojë thirrjen e ekspertit kontabël për t’u pyetur në seancë ose kryerjen e një ekspertimi nga vetë gjykata.

65. Gjykata konstaton, gjithashtu, se gjatë gjykimit nuk ka pasur prapësime të palës së paditur dhe as vendimmarrje të ndërmjetme të gjykatës për të mos lejuar marrjen si provë të aktit të ekspertimit kontabël të paraqitur nga kërkuësi, madje ky akt





është përfshirë në dosjen gjyqësore. Në vendimin e saj përfundimtar, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se akti i ekspertimit kontabël nuk përbën provë, duke referuar edhe bazën ligjore, si dhe duke theksuar se kërkuesi nuk e ka ushtruar të drejtën ligjore për të kërkuar si provë pyetjen e ekspertit. Më konkretisht, Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se *“akti i ekspertimit privat ku referon paditësi nuk përfitoi cilësinë e provës së formuar gjatë gjykimit, pasi nga momenti procedural i parashtrimit të provave që do i nënshtrobeshin debatit gjyqësor, deri në disponimin nga gjykata të vendimit të ndërmjetëm për mbylljen e hetimit gjyqësor, paditësi nuk kërkoj që ekspertja që kishte përpiluar aktin të thirrej në cilësinë e dëshmitarit...”* (shih faqen 36 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit).

66. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuetit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur se ai ka marrë përgjigje në vendimin e gjykatës së apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, kërkuetit *“i janë respektuar të gjitha të drejtat legjitime dhe ndaj tij është zhvilluar një proces i rregullt, si nga ana e organit publik, ashtu dhe nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka bërë hetim dhe analizë të thelluar të çështjes objekt shqyrtimi, duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palës paditëse”* (shih paragrafët 47 dhe 48 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

67. Për sa i takon pretendimit për standardin e arsytimit, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore të kundërshtuara përmbajnë elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuetit. Për rrjedhojë, ajo do ta analizojë në vijim çështjen vetëm në këndvështrim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, sipas standardeve të elaboruara më sipër.

68. Gjykata vëren se kërkitimi thelbësor i kërkuetit në kërkesëpadinë drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit lidhet me konkluzionin e KLGJ-së në procesin administrativ, më konkretisht me atë për moskalimin me sukses të procesit të verifikimit të pasurisë. KLGJ-ja, në nxjerrjen e këtij konkluzioni, është bazuar në analizën e raporteve të ILDKPKI-së, si institucioni shtetëror i specializuar në drejtim të ekspertizës për verifikimin e pasurive. Në funksion të këtij kërkitimi, kërkuesi ka parashtruar se akti i fundit që i është njoftuar atij nga KLGJ-ja, përpara vendimit të skualifikimit, ishte relacioni i relatorit, që përshkruante veprimet verifikuese të kryera, por nuk përmbante

konkluzione në lidhje me hetimin dhe gjetjet që mund të çonin në skualifikimin e tij si kandidat. Në këto kushte, kërkuesi ka kundërshtuar gjyqësisht vendimin e KLGJ-së për skualifikimin e tij, duke paraqitur si shkak, ndër të tjera, se procedura administrative nuk është bazuar në një analizë të plotë financiare. Për të provuar këtë pretendim, ai ka paraqitur aktin e ekspertimit kontabël, të kryer me porosi të tij, i cili në përmbajtje analizonte pozitivisht balancën financiare të kërkuetit.

69. Gjykata vëren se kërkuesi, nëpërmjet një analize teknike mbi të ardhurat dhe shpenzimet e tij në vite, synonte të provonte një pretendim të caktuar dhe me rëndësi thelbësore për çështjen e tij. Megjithatë, akti i ekspertimit kontabël nuk mori vlerën e provës në procesin gjyqësor në kuptim të ligjit procedural. Ndonëse kërkuesi e ka paraqitur këtë akt në gjykim dhe Gjykata Administrative e Apelit e ka përfshirë në dosjen gjyqësore, ajo nuk është shprehur gjatë gjykimit, qoftë edhe përmes një vendimi të ndërmjetëm refuzimi, se ky akt, në formën e paraqitur prej kërkuetit, nuk përbente provë në kuptim të ligjit procedural. Kërkuesi ka marrë dijeni për këtë qëndrim të gjykatës vetëm me vendimin përfundimtar.

70. Gjykata Administrative e Apelit, ndonëse e ngarkuar me ligj për të shqyrtuar çështjen në mënyrë të plotë nga pikëpamja e fakteve dhe e ligjit, nuk është ndalur në vlerësimin e pretendimit thelbësor të kërkuetit. Edhe pse ai nuk ka kërkuar shprehimisht thirrjen e ekspertit kontabël si dëshmitar të tij ose kryerjen e një ekspertimi kontabël nga vetë gjykata, kjo e fundit nuk ka vlerësuar nëse pretendimet e kërkuetit ishin të tilla që sillnin nevojën e dëgjimit edhe të një eksperti tjetër të specializuar, aq më tepër kur organi administrativ, KLGJ-ja, ishte asistuar në këtë proces nga një organ me ekspertizë të specializuar, siç është ILDKPKI-ja.

71. Pavarësisht se Gjykata, siç ka arsyetuar më sipër, nuk gjeti shkelje kushtetuese të procesit të rregullt në procedurën e verifikimit të kryer nga KLGJ-ja, mënyra se si ka vepruar Gjykata Administrative e Apelit vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të garantimit të barazisë së mjeteve të mbrojtjes. Këto dyshime bazohen në rrethanat konkrete të çështjes dhe lidhen në veçanti me faktin që kërkuesi ka qenë në pamundësi të kërkonte ose paraqiste ekspert në KLGJ, për sa kohë që relacioni i relatorit, i cili



është akti i fundit që njoftohet përpara vendimit administrativ të skualifikimit, edhe në kuptim të ligjit, nuk përmbante konkluzione për gjetjet mbi kriterin e pasurisë.

72. Gjykata thekson se në një gjykim të drejtë, individit mund ta ketë të vështirë të kundërshtojë raportin e një eksperti pa ndihmën e një eksperti tjetër në fushën përkatëse, pasi në të kundërt midis palëve krijohet pabarazi lidhur me mbledhjen dhe paraqitjen e provave në procesin gjyqësor. Për këtë arsye, dhe duke qenë përballë një pretendimi thelbësor të kërkuarit, Gjykata vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit nuk duhej të shpërfillte faktin se kërkuari pretendonte të kundërshtonte një raport teknik të hartuar nga një organ i specializuar – raporti i ILDKPKI-së, duke e parë këtë pretendim në aspektin e garantimit të aksesit të kërkuarit në procedimin administrativ dhe mundësisë së tij për të kërkuar marrjen e provave ose për të paraqitur të gjitha provat që ai i konsideronte të nevojshme për të mbështetur pretendimet e tij gjatë atij procesi.

73. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është garantuar parimi i barazisë së armëve, si një nga aspektet e rëndësishme të së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, që nuk i ka konstatuar dhe nuk i ka riparuar këto shkelje, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, nuk ka respektuar të drejtën e kërkuarit për proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve në gjykim është i bazuar dhe se vendimet gjyqësore duhet të shfuqizohen, si të papajtueshme me Kushtetutën.

#### *B.5. Për të drejtën e jetës private*

74. Sipas kërkuarit është cenuar e drejta e jetës private, si rezultat i vendimeve të kundërshtuara që e skualifikuan nga ndjekja e programit të trajnimit fillestar, për rrjedhojë i pamundësuan ushtrimin e profesionit të gjyqtarit, duke e prekur në dinjitetin, personalitetin dhe zhvillimin e marrëdhënieve me botën e jashtme.

75. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, për sa kohë që veprimtaria e këtij organi dhe e gjykatave ka qenë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, ndërsa skualifikimi i kërkuarit ka ardhur si

pasojë e moskalimit me sukses të procesit të vlerësimit të pasurisë.

76. Në lidhje me të drejtën kushtetuese të jetës private, Gjykata ka vlerësuar se ajo nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihen neni 35 (*mbrojtja e të dhënave personale*), neni 36 (*liria dhe fshehtësia e korrespondencës*) dhe neni 37 (*paprekshmëria e banesës*). E drejta për jetë private nuk ka karakter shterues, por, në thelb, duhet t'i sigurojë individit një hapësirë brenda së cilës ai mund të zhvillojë dhe plotësojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij, ku përfshihet edhe zhvillimi ose ruajtja në një masë të caktuar e marrëdhënieve me njerëzit e tjerë. Respektimi i jetës private kërkon në parim mosndërrhyrjen në vendimet që merr vetë individit rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 52, datë 1.12.2011; nr. 16, datë 11.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

77. Në jurisprudencën e saj për të drejtën e jetës private, sipas nenit 8 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja ka pohuar se ajo mund të përfshijë edhe veprimtari të individit me natyrë profesionale ose biznesi. Për rrjedhojë, ekziston një zonë ndërveprimi e individit me të tjerët edhe në një kontekst publik që mund të hyjë brenda fushës së veprimit të “jetës private” (*shih Peck k. Mbretërisë së Bashkuar, 28 janar 2003, §57; P.G. dhe J.H. k. Mbretërisë së Bashkuar, 25 shtator 2001, §56*). Sipas GJENDJ-së, ndërsa përfitimi ose krijimi i pasurive mund të konsiderohet se është një aspekt i jetës private, nuk është numri ose madhësia e pasurive, apo stili i jetesës në vetvete që mund t'i japin shkak përgjegjësishë disipline, por paaftësia e individit për të justifikuar ligshmërinë e burimeve për përfitimin ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij. Në çdo rast, GJENDJ-ja vlerëson se kontrolli i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të sjelljes private që trajtohet në vetvete si një shkelje etike (*shih Xhoxhaj k. Shqipërisë, 9 shkurt 2021, §362*).

78. GJEDNJ-ja ka theksuar se mosmarrëveshjet e lidhura me punësimin nuk përjashtohen *per se* nga sfera e “jetës private”, në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së. Një kufizim në lidhje me aksesin në një funksion publik mund të ketë pasoja në ushtrimin e së drejtës së jetës private, duke pasur parasysh se kjo ndalon kërkuarin të ushtrojë një profesion që i korrespondon kualifikimeve të tij profesionale (*shih Naidin k. Rumanisë, 21 tetor 2014, §32*). Ka disa aspekte tipike të jetës private, të cilat



mund të preken në mosmarrëveshjet që lidhen me masat e pavaforshme në punësim, të tilla si: shkarkimi, ulja në detyrë ose mospranimi në një profesion. Këto aspekte përfshijnë për kërkuesin: i) “rrethin e brendshëm” të tij; ii) mundësinë për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët; dhe iii) reputacionin shoqëror e profesional. Në këto lloj mosmarrëveshjes, pretendimet për cenimin e aspekteve të jetës private zakonisht vlerësohen në dy mënyra: si rezultat i shkaqeve kryesore të masës së kundërshtuar - qasja e bazuar mbi shkaqe; ose në disa raste, si rezultat i pasojave që masa e kundërshtuar sjell në jetën private - qasja e bazuar mbi pasoja. Kur çështja vlerësohet sipas qasjes së bazuar në pasoja, është me rëndësi themelore pragu i ashpërsisë së pasojave. Në këtë kuptim, i takon kërkuesit të provojë se ky prag është arritur në çështjen e tij dhe ai duhet të paraqesë prova që vërtetojnë ashpërsinë e pasojave që ka sjellë masa e kundërshtuar. Sipas GJEDNJ-së, neni 8 është i zbatueshëm vetëm kur këto pasoja janë shumë serioze dhe prekin jetën private në një masë shumë domethënëse (*shih Denisov k. Ukrainës [DHM], 25 shtator 2018, §§115, 116*).

79. GJEDNJ-ja ka përcaktuar edhe kriteret për të vlerësuar rëndësinë dhe seriozitetin e pasojave ose dëmit. Dëmi duhet të vlerësohet duke pasur parasysh jetën e kërkuesit para dhe pas masës së dhënë. Edhe pse Gjykata vlerëson efektin material dhe atë jomaterial të masës së dhënë, i takon kërkuesit të përcaktojë dhe të vërtetojë natyrën dhe masën e dëmit, i cili duhet të ketë një lidhje shkakësore me masën e kundërshtuar (*shih Denisov k. Ukrainës, [DHM], 25 shtator 2018, §117*).

80. Në rastin konkret, pretendimi i kërkuesit nuk mund të vlerësohet sipas qasjes së bazuar në shkaqe, pasi skualifikimi i tij kishte të bënte me moskalimin me sukses të procesit të verifikimit të pasurisë, pra nuk bazohej në të dhëna që lidheshin me jetën e tij private. Duke përdorur qasjen e bazuar në pasoja, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka arritur të provojë ardhjen e tyre në aspektet e jetës së tij private për shkak të procesit të verifikimit të kandidaturës së tij, i përmbyllur me skualifikimin si kandidat për magistrat.

81. Sipas kërkuesit, ai kishte studiuar në mënyrë sistematike për vite të tëra me qëllim që të përmbushte ëndrrën e tij profesionale për fitimin e së drejtës për të ndjekur Shkollën e Magistraturës, që më pas të ushtronte detyrën e gjyqtarit. Ai

pretendon se megjithëse arriti të kualifikohej profesionalisht për ndjekjen e këtyre studimeve, pas verifikimeve të KLGJ-së u skualifikua pa të drejtë. Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së jetës private në aspektet e dinjitetit, zhvillimit personal dhe të marrëdhënieve me botën e jashtme është me karakter të përgjithshëm dhe ai nuk ka arritur të argumentojë dëmin e pësuar, material dhe jomaterial, në drejtim të rëndësisë dhe seriozitetit të tij, si dhe lidhjen mes pasojës së ardhur dhe vendimit të KLGJ-së. Në këtë kuptim, ai nuk ka arritur të provojë përkeqësimin e situatës së tij ekonomike, shoqërore dhe profesionale para dhe pas këtij procesi. Pa mohuar pasojat eventuale negative që mund t'i vijnë kërkuesit nga vendimi i skualifikimit në lidhje me karrierën tij të ardhshme, përsëri procesi i verifikimit nuk barazohet me një proces disiplinor të magistratit në detyrë, për shkak të të cilit këtij të fundit i rrezikohen të drejtat e fituara tashmë.

82. Ashtu siç pranon edhe kërkuesi, ai është kualifikuar profesionalisht për të filluar studimet në Shkollën e Magistraturës, por ky kualifikim përbën fazën e parë të procedurës së emërimit, që sipas Kushtetutës përmbillet pas një procesi administrativ të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Për rrjedhojë, për kërkuesin nuk kanë lindur të drejta që lidhen me ushtrimin e profesionit ose edhe garancitë që e shoqërojnë atë. Duke qenë një proces verifikimi paraprak, kërkuesi ishte në prag të fillimit të studimeve për t'u pranuar në profesion dhe për t'u bërë pjesë e një komuniteti profesionistësh, pra ende nuk kishte përfutur të drejta me efekt financiar, shoqëror ose profesional, dhe, po ashtu, nuk kishte krijuar reputacion profesional.

83. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka provuar ardhjen e pasojave në aspektet e jetës private që lidhen me: “rrethin e tij të brendshëm”, pra të mirëqenies së tij dhe të familjes; mundësinë e krijimit dhe zhvillimit të marrëdhënieve me të tretët; reputacionin shoqëror dhe profesional. Kërkuesi e ka lidhur pretendimin për cenimin e së drejtës së jetës private me pamundësinë e ushtrimit të profesionit të gjyqtarit, e cila jo vetëm nuk është një e drejtë që buron nga normat kushtetuese, por as një e drejtë ligjore të cilën kërkuesi e kishte fituar. Duke mos provuar ardhjen e pasojave, bëhet i panevojshëm vlerësimi i ashpërsisë dhe rëndësisë së tyre, që përbën kriterin



tjetër kushtetues që duhet përmbushur kur pretendohet cenimi i së drejtës së jetës private sipas qasjes së bazuar në pasoja. Po ashtu, bëhet i panevojshëm edhe vlerësimi nëse ndërhyrja në jetën private të kërkuarit ka qenë në përputhje me ligjin, për një qëllim legjitim dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së jetës private është i pabazuar.

84. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, në drejtëm të parimit të barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor, është i bazuar, ndaj kërkesa duhet të pranohet pjesërisht sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2020-991, datë 28.12.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr. 36, datë 21.2.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

3. Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

4. Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 2.12.2021

Shpallur, më 30.12.2021

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Përparim Kalo, Altin Binaj, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Elsa Toska

Anëtare pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji

#### MENDIM PAKICE

1. Jam kundër qëndrimit të shumicës “se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është garantuar parimi i barazisë së armëve” dhe se “edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, që nuk i ka konstatuar dhe nuk i ka riparuar këto shkelje, në përputhje me parimin e subsidiaritetit, nuk ka respektuar të drejtën e kërkuarit për proces të rregullt ligjor” (shih paragrafin 73 të vendimit).

2. Vlerësoj se pretendimi i kërkuarit Emin Lusha për cenimin e parimit të barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor është i pabazuar dhe se kërkesa duhet të ishte rrëzuar në tërësinë e saj. Në mbështetje të këtij qëndrimi e çmoj të rëndësishme të paraqes në vijim argumentet e mia si gjyqtare në pakicë.

3. Kërkuari ka pretenduar, mes të tjerash, se gjatë shqyrtimit të çështjes së tij gjatë procedurës administrative dhe asaj gjyqësore, atij i është cenuar e drejta e procesit të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës për hetim efektiv, asaj për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve, standardit të arsyetimit të vendimit dhe parimit të sigurisë juridike (shih paragrafin 23 të vendimit). Në lidhje me procesin gjyqësor, më konkretisht kërkuari ka parashtruar se gjykatat kanë cenuar standardin e arsyetimit, pasi vendimet gjyqësore rendisin vetëm rrethanat e faktit, pa i interpretuar ato në raport me ligjin dhe pa u dhënë përgjigje pretendimeve kryesore të tij, përfshirë aktin e ekspertimit privat. Po ashtu, sipas kërkuarit, në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve, akti i ekspertimit, i përpiluar nga eksperti i licencuar dhe i paraqitur prej tij në gjykim, nuk është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe ky qëndrim nuk është konsideruar shkelje dhe nuk është riparuar nga Gjykata e Lartë (shih paragrafin 51 të vendimit).

4. Sipas shumicës, edhe pse kërkuari gjatë procesit gjyqësor nuk ka kërkuar shprehimisht thirrjen e ekspertit kontabël si dëshmitar të tij ose kryerjen e një ekspertimi kontabël nga vetë gjykata, kjo e fundit nuk ka vlerësuar nëse pretendimet e tij ishin të tilla që sillnin nevojën e dëgjimit edhe të një eksperti tjetër të specializuar, aq më tepër kur organi administrativ, KLGJ-ja, kishte asistuar në këtë proces nga një organ me ekspertizë të specializuar, siç është ILDKPKI-ja (shih paragrafin 70 të vendimit). Për këtë arsye shumica ka vlerësuar



se Gjykata Administrative e Apelit nuk duhej të shpërfillte faktin se kërkuesi pretendonte të kundërshtonte një raport teknik të hartuar nga një organ i specializuar – raporti i ILDKPKI-së, duke e parë këtë pretendim në aspektin e garantimit të aksesit të kërkuetit në procedimin administrativ dhe mundësisë së tij për të kërkuar marrjen e provave ose për të paraqitur të gjitha provat që ai i konsideronte të nevojshme për të mbështetur pretendimet e tij gjatë atij procesi (*shih paragrafin 72 të vendimit*).

5. Gjykata ka tashmë një praktikë të konsoliduar si në lidhje me parimin e barazisë së armëve dhe dallimit që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes së provave, dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor, të cilat janë evidentuar nga shumica, ashtu edhe për llojin e shkeljeve të rregullave procedurale që e bëjnë procesin të parregullt në aspektin kushtetues. Në lidhje me këto standarde, Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se parimi i barazisë së armëve në procesin civil është një evolucion logjik i së drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 31, datë 26.5.2014; nr. 18, datë 23.4.2013; nr. 34, datë 25.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në rastin në shqyrtim, sikurse arsyeton edhe shumica, në seancën gjyqësore të datës 12.2.2020, kërkuesi ka paraqitur parashtrimet e tij dhe pasi iu është përgjigjur pyetjeve të trupit gjykues, ka cituar aktet që ka vënë në dispozicion të gjykatës, midis të cilave, si akt provues, edhe një akt ekspertimi kontabël privat, i cili rezultoi të jetë përfshirë nga gjykata edhe në dosjen gjyqësore. Në vijim, Gjykata Administrative e Apelit ka dëgjuar edhe shpjegimet e subjektit të interesuar, KLGJ-së, në cilësinë e të paditurit në atë gjykim, dhe ka marrë vendim të ndërmjetëm për administrimin e akteve të depozituara prej tij, bashkëlidhur prapësimëve. Gjithashtu, rezultoi se gjatë seancës gjyqësore

gjykata iu ka njohur të drejtën palëve që t'i drejtojnë edhe pyetje njëra-tjetrës (*shih paragrafin nr. 64 të vendimit*).

7. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezultoi po ashtu se kërkuesi, edhe pse i asistuar gjatë këtij procesi gjyqësor nga një avokat mbrojtës, nuk ka kërkuar në asnjë moment thirrjen e ekspertit kontabël që kishte përgatitur aktin e ekspertimit të paraqitur prej tij si provë, në cilësinë e dëshmitarit për t'u pyetur në seancë gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 21, pika 4 dhe nenit 34, pika 4, të ligjit nr. 49/2012 ose kryerjen e një ekspertimi nga vetë gjykata. Fakt, gjithashtu, i rëndësishëm për rrethanat e kësaj çështjeje është që në seancën e datës 12.2.2020, kërkuesi, pasi ka paraqitur aktet që i ka bashkëlidhur kërkesëpadisë dhe ka debatuar me trupin gjykues, si dhe me palën kundërshtare në proces, i pyetur nga gjykata për vazhdimin e gjykimit është shprehur që “*t'i jepet fund hetimit gjyqësor*”, duke kërkuar kohë për të përgatitur konkluzionet përfundimtare me shkrim.

8. Nga ana tjetër, në vendimin e saj përfundimtar, Gjykata Administrative e Apelit është shprehur edhe për aktin e ekspertimit kontabël të depozituar nga kërkuesi, duke arsyetuar se ai nuk përbën provë, pasi, bazuar në nenin 21, pika 4 dhe nenin 34, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, kërkuesi nuk e ka ushtruar të drejtën ligjore për të kërkuar si provë pyetjen e ekspertit si dëshmitar. Më konkretisht, Gjykata Administrative e Apelit është shprehur se “*akti i ekspertimit privat ku referon paditësi nuk përfitoi cilësinë e provës së formuar gjatë gjykimit, pasi nga momenti procedural i parashtrimit të provave që do i nënshtroreshin debatit gjyqësor, deri në disponimin nga gjykata të vendimit të ndërmjetëm për mbylljen e hetimit gjyqësor, paditësi nuk kërkoi që ekspertja që kishte përpiluar aktin të thirrej në cilësinë e dëshmitarit bazuar në nenin 34, pika 4, të ligjit nr. 49/2012*” (*shih faqen 36 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

9. Kurse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në lidhje me pretendimin e kërkuetit të ngritur në rekurs për mosmarrjen parasysh të aktit të ekspertimit nga gjykata e apelit, pasi e ka marrë në shqyrtim është shprehur se ky pretendim ka marrë përgjigje në vendimin e gjykatës së apelit dhe se “*rregullimi i përcaktuar në nenin 21, pika 4 dhe nenin 34, pika 4, të ligjit nr. 49/2012, për thirrjen në gjykim të ekspertit të palës me statusin e dëshmitarit, vendos detyrimin mbi paditësin*” (*shih paragrafin 46 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).



10. Në vlerësimin tim, në ndryshim nga sa arsyeton shumica, parashtrimi i pretendimeve dhe provave, si dhe kërkimi i tyre sipas rregullave procedurale përkatëse, është në disponibilitetin e vetë palës, e cila duhet t'i sjellë ato në vëmendjen e gjykatës, sipas prioritetit që kanë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Pra, është përgjegjësi e palës jo vetëm të evidentojë përpara gjykatës provën/provat, që sipas saj kanë një rëndësi vendimtare për çështjen, por të respektojë përcaktimet ligjore për mënyrën e kërkimit të tyre. Duke qenë se problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018 të Gjykatës Kushtetuese), vlerësoj se roli i gjykatës së zakonshme, në aspektin kushtetues, nuk mund të jetë edukimi i palës gjatë procesit, por ai i një arbitri midis palëve ndërgjyqëse.

11. Bazuar në sa më lart, arsyetimin e shumicës e konsideroj të sforcuar dhe kontradiktor, pasi ajo nuk ka arritur të argumentojë se cili nga aspektet e parimit të barazisë së armëve, të përcaktuar nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e GJEDNJ-së, është cenuar në rastin në shqyrtim. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica dhe në përputhje me standardet që imponon e drejta për proces të rregullt, kërkuesi ka qenë prezent gjatë procesit gjyqësor dhe atij i është dhënë mundësia për të paraqitur argumentet dhe provat në lidhje me çështjen, si dhe për të debatuar mbi to dhe nuk është vënë në disavantazh në krahasim me palën kundërshtare. Gjithashtu, edhe pse kërkuesi pretendon se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shqyrtuar aktin e ekspertimit të përpiluar nga një ekspert i licencuar, në seancën e datës 12.2.2020, kur është deklaruar i hapur debati gjyqësor, pavarësisht se trupë gjykues nuk ka caktuar paraqitjen në seancë, në cilësinë e dëshmitarit, të ekspertit, ai nuk ka kërkuar në asnjë moment që të diskutohej për aktin e ekspertimit, por ka qenë dakord me mbylljen e hetimit gjyqësor në po atë seancë. Për më tepër, pretendimi i tij ka marrë përgjigje të arsyetuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat kanë arsyetuar në lidhje me aktin e ekspertimit kontabël dhe kanë dhënë argumente se përse në kuptim të ligjit procedural ky akt nuk mund të marrë cilësinë e provës.

12. Në vlerësimin tim, argumenti i shumicës se “mënyra se si ka vepruar Gjykata Administrative e Apelit vë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të garantimit të barazisë së mjeteve të mbrojtjes. Këto dyshime bazohen në rrethanat konkrete të çështjes dhe lidhen në veçanti me faktin që kërkuesi ka qenë në pamundësi të kërkonte ose paraqiste ekspert në KLGJ, për sa kohë që relacioni i relatorit, i cili është akti i fundit që njoftobet përpara vendimit administrativ të skualifikimit, edhe në kuptim të ligjit, nuk përmbante konkluzione për gjetjet mbi kriterin e pasurisë” (shih paragrafin 71 të vendimit), është i pamjaftueshëm për të justifikuar pranimin e këtij pretendimi.

13. Edhe vendimet e GJEDNJ-së të cituara nga shumica nuk i përshtaten rastit në fjalë. Disa prej tyre kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit të brendshëm nga gjykatat (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano k. Italisë* [DHM], 7 qershor 2012; *Miragall Escolano dhe të tjerë k. Spanjës*, 25 janar 2000). Ndërsa në çështjen Devinar k. Sllovenisë, datë 22 maj 2018 (paragrafi 62), aplikanti pretendonte cenim të parimit të barazisë së armëve, pasi gjykatat i kishin mbështetur vendimet në opinionin e komisionit për aftësinë e kufizuar/paaftësinë për punë, të cilat shpesh ishin të pasakta dhe se atij nuk i ishte dhënë mundësia të paraqiste një opinion nga një ekspert i caktuar nga gjykata. GJEDNJ-ja vërejti se aplikanti kishte një mundësi për të kundërshtuar vendimet përkatëse para Gjykatës së Punës (...), e cila mbajti një seancë dëgjimore në të cilën ai ishte në gjendje të parashtronte argumentet e tij në lidhje, ndër të tjera, me gjetjet e opinionëve të komisionëve të aftësisë së kufizuar. Prandaj, Gjykata vërejti se ndërsa opinionet e komisionëve të aftësisë së kufizuar patën (...) një ndikim të rëndësishëm në rezultatin e procesit, aplikanti ishte vënë në dijeni për to dhe iu dha mundësia t'i kundërshtonte ato me shkrim në një seancë dëgjimore para Gjykatës së Punës. Ai mund të kishte paraqitur kundërshtime specifike në lidhje me objektivitetin e komisionëve të aftësisë së kufizuar dhe gjetjet e tyre, si dhe të mbështeste pikëpamjen e tij duke paraqitur një mendim nga mjeku i tij i përgjithshëm (...), bazuar në përfundimin se nuk u paraqit asnjë argument specifik nga ai për të vënë në dyshim objektivitetin e nevojshëm të komisionëve përkatëse të aftësisë së kufizuar ose saktësinë e gjetjeve të tyre - dhe duke vënë në dukje se asnjë mangësi tjetër (si mungesa e pjesëmarrjes efektive në procedurat para



komisioneve të aftësisë së kufizuar) nuk u pretendua nga aplikanti - procedurat e konsideruara në tërësi nuk ishin në kundërshtim me kërkesat e një gjykimi të drejtë (*shih paragrafët nr. 55, 56 dhe 58 të vendimit të GJEDNJ-së*).

14. Për argumentet e parashtruara më sipër, vlerësoj se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi Emin Lusha janë të pabazuara, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual duhej të ishte rrëzuar nga Gjykata në tërësinë e tij.

ANËTARE  
Fiona Papajorgji

**VENDIM**  
Nr. 230, datë 15.11.2021

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES  
SË BORDIT NË LIDHJE ME KËRKESËN  
E SHOQËRISË “ELVA 2001” SHA, PËR  
TRANSFERIMIN E ASETETEVE TË  
PALUAJTSHME (VENDOSJE  
HIPOTEKE) NË FAVOR TË “INTESA  
SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 1.3, të licencës “Për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; nenit 11, të “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016; nenit 67, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/5 prot., datë 11.11.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Elva 2001’ sh.a., për transferimin e asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke) në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Elva 2001” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me

vendimin e Bordit të ERE-s nr. 217, datë 20.12.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 16.8.2021, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Elva 2001” sh.a. për lënien peng të asetëve të paluajtshme në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a.

- Në vijim, me vendimin nr. 214, datë 15.10.2021, Bordi i ERE-s, vendosi:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për transferimin e asetëve (vendosje hipoteke), në favor të Intesa San Paolo Bank sh.a.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja e vendimit, shoqëria “Elva 2001” sh.a. të depozitohet në ERE:

a) listën e transferimeve të kryera më herët, nëse ka pasur;

b) informacion përkatës në lidhje me diferencën e konsiderueshme mes principalit të kredive dhe vlerës së asetëve të paluajtshme, mbi të cilat do të vendoset hipoteka.

- Në zbatim të këtij vendimi, shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën e nënshkruar nga administratori, ku deklarohet se nuk ka pasur transferime të tjera të kryera më herët.

-Për sa i përket informacionit të përcaktuar në pikën 2, germa “b”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 214/2021, shoqëria ka deklaruar se diferenca e vlerës së asetëve sipas pasqyrave financiare për HEC “Mivas” dhe vlerës së principalit të kredive është financim me mjete të kompanisë “Elva 2001” sh.a. Po ashtu, shoqëria shprehet se e ka informuar më herët ERE-n në lidhje me financimin e kësaj difference me fondet e vetë shoqërisë.

-Sa më sipër, konstatohet se shoqëria nuk ka kuptuar qartë kërkesat specifike të germës “b”, të pikës të këtij vendimi, pasi në zbatim të kësaj pike nevojitet informacion mbi diferencën ndërmjet principalit të kredive dhe vlerës së asetëve për të cilat po kërkon autorizimin për t’i vendosur si mjete garantuese të këtyre kredive, dhe jo informacion mbi vlerën fillestare të investimit dhe mënyrës së financimit të saj.

- Përveç sa më sipër, nevojitet që subjekti të saktësojë dhe qëndrimin e MIE-s, të mbajtur në shkresën nr. 2771/1 prot., datë 16.6.2021, drejtuar Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në lidhje me nevojën e marrjes ose jo të miratimit të MIE-s mbi këtë transferim.



- Me qëllim orientimin e drejtë të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s dhe saktësimin/qartësimin e sa më sipër, duke përfshirë dhe zhvillimin e seancave të mundshme dëgjimore, në zbatim të nenit 67, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, vlerësohet të shtyhet me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrja e Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a. për transferimin e asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të Intesa San Paolo Bank sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen mbi kërkesën e shoqërisë “Elva 2001” sh.a., për transferimin e asetëve të paluajtshme (vendosje hipoteke), në favor të Intesa San Paolo Bank sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM

**Nr. 231, datë 15.11.2021**

**MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 360,  
SERIA T17, PËR VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË  
“BALKAN ENERGY TRADE” SHPK, ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 37,  
DATË 6.3.2017**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 17, pika 4 dhe nenit 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, germa “ç” dhe nenit 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,

datë 17.6.2016; si dhe pikës 3.6.4 dhe pikës 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/3 prot., datë 10.11.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi heqjen e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 192, datë 10.9.2021, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017, për arsye se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregulatore të vitit 2020, për licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 948 prot., datë 15.9.2021, ERE i ka njoftuar shoqërisë vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Po ashtu kjo shkresë i është dërguar shoqërisë, e skanuar me postë elektronike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 193, datë 10.9.2021, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 5.10.2021. Shkresa e dërguar shoqërisë është kthyer nga posta. Në këto rrethana, përveç sa më sipër, shoqëria nuk ka zbatuar dhe përcaktimet e pikës 3.6.4, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar (duke e përlllogaritur këtë afat 30 ditë nga marrja dijoni nga publikimi në Fletoren Zyrtare) rezultoi se subjekti nuk ka marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e





procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse.

- në nenin 42, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, germa “ç”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe pikën 5.1, germa “ç”, të “Kushteve të licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike”, parashikohet se: ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje, në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017, shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 360, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 37, datë 6.3.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 232, datë 15.11.2021

**MBI HEQJEN E LICENCËS NR. 369,  
SERIA TGN17, PËR VEPRIMTARINË E  
TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR,  
DHËNË SHOQËRISË “C.G.C” SHPK, ME  
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 73,  
DATË 16.5.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 14 dhe nenit 27, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 5, germa “ç” dhe nenit 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; nenit 15, të rregullores PPër organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-sP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe nenit 4, pika 8, germa “a”, dhe nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 30.1.2018; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 140/2 prot., datë 10.11.2021, të përgatitur nga grupi i punës, “Mbi heqjen e licencës nr. 368, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë ‘C.G.C’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 10.9.2021, vendosi fillimin e procedurës për heqjen



e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C”, sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017, për arsye se shoqëria “C.G.C” sh.p.k. nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2020, për licencën për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 946 prot., datë 15.9.2021, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Po ashtu kjo shkresë i është dërguar shoqërisë e skanuar me postë elektronike.

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 193, datë 10.9.2021, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 5.10.2021. Shkresa e dërguar shoqërisë është kthyer nga posta.

- Në këto rrethana, përveç sa më sipër, shoqëria nuk ka zbatuar dhe përcaktimet e nenit 4, pika 8, germa “a”, të kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, ku është parashikuar detyrimi i të licencuarve për të njoftuar ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të adresës.

- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar (duke e përlogaritur këtë afat 30 ditë nga marrja dijoni nga publikimi në Fletoren Zyrtare) rezultoi se subjekti nuk ka marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk janë bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.

- Në nenin 14, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikohet se: ERE përcakton dhe miraton pagesat e aplikimit për licencë dhe pagesat rregullatore për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, në përputhje me metodologjinë e miratuar prej saj.

- Në nenin 27, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, nenin 5, germa “ç”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenin 9, pika 1, germa “d”, të

“Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror”, parashikohet se ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.

- Në nenin 9, germa “c”, të rregullores “Për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se:

Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas neneve 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d”, të nenit 5, të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8, të kësaj rregulloreje.

- Me heqjen e licencës nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017, shoqëria “C.G.C” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të heqë licencën nr. 369, seria TGN17, për veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror, dhënë shoqërisë “C.G.C” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 16.5.2017.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.

3. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 236, datë 26.11.2021**

**MBI ZGJATJEN E AFATEVE TË  
PËRCAKTUARA NË VENDIMIN E  
BORDIT TË ERE-s NR. 171, DATË  
16.8.2021, “PËR MIRATIMIN E  
PROGRAMIT TË PËRPUTHSHMËRISË  
SË OPERATORIT TË SISTEMIT TË  
TRANSMETIMIT PËR GAZIN  
NATYROR, ‘ALBGAZ’ SHA”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 144/6 prot., datë 23.11.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi zgjatjen e afateve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, ‘Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 171, datë 16.8.2021, ka vendosur:

1. Të miratojë Programin e Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, “Albgaz” sh.a., me kushtin që shoqëria brenda 3 muajve ta depozitojë atë në ERE të përditësuar me përcaktimet sipas kërkesave të pikës 5, pikës 6 dhe pikës 15, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.5.2017.

2. Mosplotësimi i kushtit, sipas përcaktimeve të pikës 1, përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 53/8 prot., datë 16.11.2021, shoqëria “Albgaz” sh.a. ka depozituar kërkesën për shtyrjen me 3 (tre) muaj të afatit të përcaktuar në pikën 1, të vendimit

të sipërcituar, duke u shprehur se ka marrë të gjitha masat për të plotësuar kushtet e vendimit dhe aktualisht është në proces konsultimi me aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.

- Në nenin 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 3 (tre) muaj, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, afatin e përcaktuar në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 171, datë 16.8.2021, “Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, ‘Albgaz’ sh.a.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 237, datë 26.11.2021**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS  
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2”  
SHPK, NË VEPRIMTARINË E  
FURNIZIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, si dhe nenit 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe



heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 144/3 prot, datë 17.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1076 prot., datë 11.11.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., rezultoi se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacionit për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “e”, plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat “a”, “c”, “d”, plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika “a”, “c”, plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Formatit dhe dokumentacionit për aplikim, neni 9, pika 1, germa “c” (të dhëna për aplikuesin);

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata);

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit /ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë, shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit).

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj); germa “e” (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi); germa “g” (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve); germa “i” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët).

Subjekti do të njoftohet që në bazë të neneve 10, pikat 10 dhe 11, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
Petrit Ahmeti







*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik  
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 608 lekë